

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

**18.10.2024
Ora, 10:10**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-------|--------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Majlinda Çelmeta, Jona Josifi. |

Parti Politike: PD (F. Nuri), PSSH (E. Xhina)

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme, datë 18 tetor, ora 10:00. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretaria e Përgjithshme dhe zyrtarë të tjerë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Me sa shoh në vendin ku ulen përfaqësuesit e partive politike, kemi përfaqësues të partive politike, për të cilët më duhen autorizimet përkatëse, dhe t'i konfirmojë administrata. Kemi mediat të pranishme. Nga shoqëria civile kemi? Kemi përfaqësues të një organizate! Siç jeni njoftuar, në mbledhjen e Komisionit Rregullator të ditës së sotme kemi për të shqyrtuar një

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

projektvendim, projektvendimin “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”. Sikundër jeni në dijeni me ndryshimet më të fundit të Kodit Zgjedhor, në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë, këto ndryshime i ka adresuar edhe lidhur me çështjen e votimit të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit. Ky është akti i parë që ne ndërmarrim sot, nëpërmjet shqyrtimit të këtij projektvendimi për të mundësuar realisht votimin e shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit në zgjedhjet e pritshme të vitit 2025. Projektvendimi është propozuar në Komisionin Rregullator nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kështu që unë do të doja nga Sekretaria e Përgjithshme një prezantim të shkurtër. Më tej dhe nga Drejtoria e Votimit nga Jashtë një prezantim më të zgjeruar për të kuptuar se si kemi ardhur në këtë projektvendim. Procesin e konsultimit dhe çfarë përmban projektvendimi. Zonja Çelmeta, ju lutem! Ndjesë zonja Çelmeta, për procedurë, përpara se të fillojmë me shqyrtimin e këtij projektvendimi, më duhet të pyes kolegët nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Nëse ka do të diskutohen në fund. Kolegë keni diçka? Nuk ka çështje jashtë rendit të ditës. Fillojmë me rendin e ditës.

Znj. M. Çelmeta: E nderuar zonja Kryetare, të nderuar anëtarë! Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve” është hartuar në mbështetje të ndryshimeve më të fundit të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend, me qëllim garantimin e të drejtës së votës të çdo shtetasi shqiptar që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në datën e zgjedhjeve. Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, “Kodi Zgjedhor i Republikës së

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projekaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit. Për shpjegime të mëtejshme, po ia kaloj fjalën drejtores së Drejtorisë së Votimit nga Jashtë që ka përgatitur projektaktin, zonjës Josifi.

Znj. I. Nano: Zonja Josifi, mundet tani të na prezantoni, nuk do të thoja në mënyrë të përmbledhur, por në mënyrë të zgjeruar procesin e hartimit të këtij projektvendimi dhe çfarë përmban ai, në fund të fundit.

Znj. J. Josifi: Faleminderit për fjalën, e nderuar zonja kryetare e Komisionit Rregullator, të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator! Unë po vijoj aty ku ndaloi Sekretaria e Përgjithshme, në vijim të shpjegimeve për projektaktin që është paraqitur sot përpara jush me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Neni 25, pikat 1 dhe 12, të Kodit Zgjedhor parashikojnë se zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet e radhës për Kuvendin duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Kod dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Komisioni Rregullator, me propozimin e Komisionerit, miraton aktet e nevojshme normative nënligjore për përbërësit e listës së zgjedhësve jashtë vendit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, mënyrën dhe afatet e komunikimit me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe eventualisht bazë tjetër të dhënash, si dhe modalitetet dhe rregullat të tjera teknike të hartimit të kësaj liste. Zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet e radhës për Kuvendin duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit. Pas hapjes së procesit të regjistrimit nga KQZ-ja zgjedhësi

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

aplikon në mënyrë individuale për regjistrim në listën e këtyre zgjedhësve. “KQZ...”, thotë Kodi, “...krijon, mirëmban dhe përditëson platformën elektronike për regjistrimin e kërkesave të zgjedhësve që dëshirojnë të votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Për këtë, zgjedhësi paraqet dokumentacion që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në nenin 46, pika 3 të Kodit Zgjedhor, parashikohet se lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përfshin vetëm zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit, të cilët deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas rregullave të dala në zbatim të nenit 24 të Kodit. Projektakti që keni sot përpara jush për miratim, fillimisht rendit parimet të cilat janë shtyllat ku do të mbështetet procesi i regjistrimit të zgjedhësve nga jashtë vendit. Përfshirja e tyre në projektakt, në fakt, erdhi si sugjerim i Organizatës “Diaspora për Shqipërinë e Lirë”. Është një sugjerim që u pranua përgjatë konsultimit që Komisioneri bëri përpara se të sillte para jush këtë akt. Në projektakt janë sqaruar parimet e transparencës, të thjeshtësisë, të lehtësisë, i efektshmërisë, aksesit të barabartë dhe i diskrecionit. Konkretisht, procesi i regjistrimit dhe votimit për zgjedhësit jashtë vendit duhet të jetë i hapur dhe i monitoruar në mënyrë që të garantohet informimi i duhur i publikut, i subjekteve zgjedhore, apo i çdo pale tjetër me interes në këtë gjë. Në këtë drejtim edhe është konsultuar ky projektakt, ashtu sikundër edhe projektaktet që do të vijnë lidhur me procesin e votimit nga jashtë vendit. Parimi i thjeshtësisë dhe lehtësisë procedurat e regjistrimit dhe të votimit për zgjedhësit jashtë vendit duhet të jenë të thjeshta dhe të lehta për t’u kuptuar, por edhe për t’u ndjekur nga zgjedhësit, duke minimizuar, për aq sa do të jetë e mundur, barrën administrative dhe teknike. Parimi i efektshmërisë, procedurat për regjistrimin do të duhet të jenë efektive, duke synuar, që të arrihet qëllimi final, pra që në fund, vota e çdo shtetasi që jeton jashtë, të realizohet në kohë dhe pa krijuar pengesa të panevojshme, përkundrazi në përpjekje për të krijuar lehtësi. Parimi i aksesit të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

barabartë, çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote, pavarësisht vendndodhjes së tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do duhet të ketë mundësi të barabarta për të votuar dhe pavarësisht territorit se ku gjendet jashtë. Parimi i diskrecionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ashtu siç e ka parashikuar edhe Kodi që administron të gjithë procesin e votimit nga jashtë me të gjithë elementët e tij, ka të drejtën të veprojë me diskrecion brenda limiteve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e votës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Ky diskrecioni do të duhet të jetë në funksion të përmirësimit të procesit si dhe të adresimit të situatave të paparashikuara që mund të dalin. Në kreun II të këtij projektvendimi janë parashikuara rregulla të përgjithshme të përcaktuara në ndryshimet më të fundit të ligjit, të Kodit Zgjedhor për sa i përket regjistrimit të zgjedhësve dhe institucionit kompetent për të administruar këtë proces, në këtë rast Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në kreun III kemi parashtruar rregullat që lidhen me paraqitjen e kërkesës për regjistrim, nga ana e zgjedhësit, afatet që ai do të ketë në dispozicion deri në momentin e regjistrimit në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit. Në zbatim të nenit 25, pika 4 dhe 5 të Kodit Zgjedhor, kërkesa për regjistrim nga zgjedhësi do të bëhet në mënyrë individuale nga vetë zgjedhësi. Kjo kërkesë i drejtohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas procedurave të parashikuara në këtë projektvendim, nëse do të jetë ky vullneti i Komisionit Rregullator. Afati për paraqitjen e kërkesës fillon 120 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 68 ditë para kësaj date. Hapja e procesit të hartimit të listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit, siç e thotë dhe Kodi do të bëhet jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të këtij procesi. Me qëllimin e vetëm që të ketë kohën e mjaftueshme për zgjedhësit jashtë për të marrë të gjithë informacionin e duhur, por dhe për të siguruar të gjitha të dhënat vetjake të cilat do të duhet t'i japin gjatë kërkesës së tyre për regjistrim. “Kërkesa për regjistrim...”, në zbatim të parashikimeve të nenit 25, pika 5 të Kodit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Zgjedhor, “.. do të duhet të bëhet në platformën elektronike e cila krijohet, mirëmbahet dhe përditësohet nga KQZ..”, thotë Kodi. Propozimi për ta pasur këtë platformë në të dy versionet mobile dhe desktop, si dhe për të qenë pa pagesë për zgjedhësit, që do të mbulohet nga Buxheti i Shtetit, bëhet për të ulur barrën e kostos tek zgjedhësi, por dhe për të mundësuar aksesin për të gjithë zgjedhësit, pavarësisht llojit të paisjes që ata disponojnë. E thënë thjesht, regjistrimi mund të bëhet nga çdo telefon celular, pavarësisht nëse është android, apo një lloj tjetër, nga çdo laptop, nga çdo kompjuter, tablet, apo paisje tjetër. Fillimisht, zgjedhësi krijon një llogari në Platformën Elektronike të Regjistrimit, të cilët do të duhet ta aksesojë atë çdo herë nëpërmjet përdorimit të tre faktorëve të autentifikimit, që ne i kemi sjellë si propozim për të rritur sigurinë e aksesit në këtë sistem, por edhe për të verifikuar me sa më shumë faktorë, faktin që vërtet kjo kërkesë për regjistrim siç e parashikon Kodi, bëhet individualisht dhe bëhet nga vetë zgjedhësi dhe vetëm nga ai. Tre faktorët që kemi propozuar janë: identifikimi biometrik me njohje të fytyrës, pra zgjedhësi do të duhet të dalë para kameras së paisjes së tij, kodi unik 6 shifror që i dërgohet si në numrin e telefonit mobil dhe email, si dhe numrit personal meqenëse ai identifikon në mënyrë unike një shtetas shqiptar, si dhe fjalëkalimi, që është vendosur nga vetë zgjedhësi. Pas krijimit të llogarisë, zgjedhësi skanon një dokument të vlefshëm identifikimi të lëshuar nga Republika e Shqipërisë (pasaporta ose letërnjoftim) këto të dhëna lexohen nga platforma elektronike. Nëse këto të dhëna për arsye të ndryshme të ndonjë dëmtimi të dokumentit të identifikimit, apo të paqartësisë, zgjedhësi do të ketë mundësinë të japë këto të dhëna në mënyrë manuale. Më pas, zgjedhësi ngarkon një nga dokumentet që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Lista e dokumenteve që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të miratohet me akt të veçantë të Rregullatorit, siç e ka parashikuar neni 25, pika 5 e Kodit Zgjedhor, të cilat nuk janë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

përfshirë në këtë projektvendim. Gjatë fazës së konsultimit të këtij projektakti u vu re nga organizatat, por dhe vetë diaspora, kishin mendime të ndryshme për sa i takon listës së këtij dokumentacioni. Kjo është arsyeja që ne, në draftin e parë që qarkulluam dhe projektaktin që ju keni sot përpara jush, e kemi eskluduar këtë listë, për t'i dhënë më shumë kohë këtyre diskutimeve, deri sa të ketë një dakordësi të përgjithshme. Në fund, zgjedhësi ngarkon në PER të dhënat e tij të kontaktit, që përfshijnë adresën personale të postës elektronike (email), numrin e celularit personal që disponon, si dhe të dhënat e adresës së banimit të shtypura, të cilat në projektvendim janë të renditura në mënyrë shteruese: shtetin, kodin postar, qytetin, emërtesën e rrugës, numrin e banesës, elemente të tjera të adresës nëse ka, sipas rastit, sipas vendit ku zgjedhësi banon. Në kreun IV të këtij projektvendimi, përcaktohet mënyra se si kërkesa që erdhi, të parashtruara në Kreun III, do të shqyrtohet nga ana e KQZ. ardhura në PER. Pas kryerjes së kërkesës për regjistrim nga ana e zgjedhësit, përmes ndërveprimit në kohë reale me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, PER kontrollon saktësinë dhe përputhshmërinë e të dhënave të identitetit të deklaruara nga zgjedhësit, me ato të cilat gjenden në dokumentin e identifikimit në RKGjC. Nëse të dhënat që kërkohen të verifikohen nga KQZ në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, neni 25, pika 6 janë të njëjta, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile respektivisht në zbatim të nenit 25, pika 6 të Kodit, bën regjistrimin e adresës që shtetasi deklaroi gjatë procesit të regjistrimit në një rubrikë të veçantë, RKGjC. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shqyrton kërkesën për regjistrim të zgjedhësit brenda 5 ditëve kalendarike nga marrja e saj nëpërmjet PER me qëllim që të kemi kohën e mjaftueshme për shqyrtimin e këtyre kërkesave si dhe për t'i dhënë kohë vehtes, pasi ne nuk e dimë sot se sa do të jetë volumi i kërkesave për regjistrim përgjatë gjithë periudhës që ka parashikuar Kodi. Mund të kemi kërkesa për regjistrim në një numër të vogël në një ditë të caktuar, po në një numër

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

të madh në një ditë tjetër. Prandaj menduam një afat të arsyeshëm prej 5 ditësh kalendarike. Vendimi nëse do të përfshihet, apo jo në listën paraprake të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit në të njëjtën rrugë me të cilën u muar dhe kërkesa e tij për regjistrim. Pra, në këtë platformë, por njoftimi do t'i shkojë dhe në adresën e email-it të deklaruar prej tij. Nëse këto të dhëna nuk janë të sakta, pra nuk janë të njëjta me ato të zgjedhësit në RKGjC, PER njofton me mesazh zgjedhësit për saktësimin e tyre deri në përfundim të afatit të përcaktuar në Kod, gjatë gjithë periudhës së regjistrimit dhe në korrigjimin e tyre. Kreu V i këtij projektvendimi, përcakton përbërësit e listës së zgjedhësve jashtë vendit, mënyrën dhe afatet e komunikimit me RKGjC, si dhe modalitetet e rregullat e tjera teknike të hartimit të kësaj liste. Duke qenë se në zbatim të nenit 25, pika 3 të Kodit Zgjedhor, përcaktohet se lista e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit hartohet dhe përdoret rishtazi për çdo palë zgjedhje për Kuvendin, duke respektuar afatet kufitare për përgatitjen e listës si dhe publikimin e asaj paraprake dhe përfundimtare të bëra sipas parashikimeve në nenin 25, pikat 4 dhe 7, të Kodit Zgjedhor në këtë projektvendim janë përcaktuar afatet si vijon:

- Pas përfundimit të afatit për regjistrim, DPGJC nxjerr nga Regjistri (RKGjC) listën paraprake të zgjedhësve nga jashtë vendit dhe ia dërgon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, jo më vonë se 63 ditë para datës së zgjedhjeve.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 63 ditë para datës së zgjedhjeve, publikon listën paraprake të zgjedhësve me qëllim që zgjedhësit brenda 48 orësh nga publikimi i saj mund të kërkojnë regjistrimin apo rregullimin e pasaktësive. Pas kalimit të këtij afati për rregullimin e pasaktësive në regjistrim, Komisioneri miraton dhe publikon në faqen zyrtare të internetit të KQZ listën përfundimtare të zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit 60 ditë para datës së zgjedhjeve. Sërish sipas pikës 8, të nenit 25 kjo listë e zgjedhësve është përcaktuar, se pas përfundimit të këtij procesi nuk ndryshon

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak pas afatit të parashikuar në këtë pikë, duke dhënë në vijim edhe mundësinë për ankimim edhe në gjykatë, po ecim me elementët e listës njëherë. Neni 45 i Kodit Zgjedhor përcakton përbërësit zgjedhorë të listës së zgjedhësve. Në rastin e listës së zgjedhësve nga jashtë vendit janë parashikuar të përcaktohen me akt të Komisionit Rregullator, gjithashtu dhe teknikalitetet e tjera të hartimit të listës. Në projektaktin që keni përpara jush propozimin tonë për përcaktimin e përbërësve të kësaj liste, u përdorën për analogji përbërësit e listës brenda vendit të cilët përfshijnë përbërësit zgjedhorë të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “f” të pikës 1 të nenit 45 të Kodit Zgjedhor, por të përshtatur në kontekstin e votimit nga jashtë ku nuk ka kuptim të flitet për kod banese apo ZAZ dhe në këtë rast si përbërës i kësaj liste është përfshirë shteti i vendbanimit të zgjedhësit që voton jashtë vendit, i cili gjendet në rubrikën e veçantë në RKGjC ku është regjistruar adresa e zgjedhësit. Në bazë të nenit 25, pika 2 e Kodit Zgjedhor, përcaktohet se lista e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit është një listë e vetme në nivel zone zgjedhore dhe përmban listën e shtetasve shqiptarë që kanë shprehur vullnetin të votojnë nga jashtë vendit sipas rregullave që do të miratohen nga Komisioni Rregullator. Në kuadër të kësaj analogjie midis listës së zgjedhësve brenda vendit me atë jashtë vendit, është propozuar në këtë projektvendim që si përfundim, lista e zgjedhësve nga jashtë vendit të përmbajë: emërtimin e zonës zgjedhore, llojin dhe datën e zgjedhjeve, përbërësit zgjedhorë të zgjedhësve, që i citova pak më lart. Për sa i takon formateve të listës së zgjedhësve dhe publikimit të tyre, jemi përpjekur sërish të bëjmë një analogji me përmbajtjen dhe formatin e listës së zgjedhësve brenda vendit sipas përcaktimeve të nenit 48 të Kodit Zgjedhor, sërish me përpjekjen për t’i përshtatur ato në këtë kontekst të votimit nga jashtë vendit. Konkretisht, është përcaktuar listë zgjedhësish në nivel zone zgjedhore dhe në përbërësit zgjedhorë që publikohen në vend të kodit të vendbanimit është

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

parashikuar shteti i vendbanimit jashtë ashtu sikurse lista e zgjedhësve në formë të printuar në këtë rast, për mendimin tonë, del e panevojshme, se nuk ka kuptim të afishohet në ndonjë nga njësitet administrative, apo bashkitë, është propozuar që në këtë rast të ketë vetëm listë në format elektronik për t'u publikuar dhe e aksesuar lehtësisht nga zgjedhësit jashtë. Konkretisht, lista e zgjedhësve është propozuar të hartohet në 2 formate:

1 - listë zgjedhësish në nivel zone zgjedhore në formë elektronike për publikim si nga KQZ dhe DPGjC, që do të përmbajë përbërësit zgjedhorë të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” të nenit 45 të Kodit Zgjedhor. Përveç këtyre, emërtimin e zonës zgjedhore, llojin dhe datën e zgjedhjeve, si dhe shtetin e vendbanimit të zgjedhësit që voton nga jashtë vendit dhe që është regjistruar.

2 - përmbledhje e të gjithë zgjedhësve në nivel vendi, për analogji me listën në nivel vendi, brenda vendit. Në këtë rast në formë elektronike për publikim nga KQZ dhe DPGjC metë njëjtën përmbajtje sipas shkronjës “a” të kësaj pike. Zgjedhësit në listë, kemi propozuar ne, do të renditen sipas rendit alfabetik të mbiemrit, ashtu sikurse ndodh edhe për listën e zgjedhësve brenda vendit. Referuar nenit 25, pika 8, të Kodit Zgjedhor, zgjedhësit i njihet e drejta për të paraqitur kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë deri në 7 ditë para datës së zgjedhjeve, në rastet kur ka paraqitur kërkesë për regjistrim në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit dhe vëren se nuk është i regjistruar në këtë listë, ose regjistrimi i tij ka pasaktësi. Gjykata e shqyrton dhe vendos në lidhje me kërkesën, sipas kësaj pike, brenda 24 orëve nga data e regjistrimit të kërkesës, por jo më vonë së 5 ditë para datës së zgjedhjeve. Emri dhe të dhënat e tjera të zgjedhësit që i shtohet listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit, i bashkëngjitet vendimi i gjykatës. Edhe kjo është lënë në projektakt si një referim i Kodit Zgjedhor, ekzaktësisht siç është parashikuar në Kod. Në bazë të nenit 56 të Kodit Zgjedhor, shtetasit shqiptarë që

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

janë regjistruar në listën e zgjedhësve jashtë vendit, pas përfundimit të procedurës së regjistrimit sipas këtij vendimi, ç’regjistrohen nga lista e zgjedhësve brenda vendit. Në lidhje me hartimin e listës së zgjedhësve sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 1, të Kodit Zgjedhor, DPGjC harton listën e zgjedhësve duke hequr nga kjo listë emrat e atyre personave që janë të regjistruar në regjistrin e shtetasve që votojnë nga jashtë vendit. Mënyra e bashkëpunimit mes KQZ-së dhe DPGjC-së për çregjistrimin do të adresohet, thotë Kodi Zgjedhor, me akt të përbashkët midis Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Ministrit përgjegjës për gjendjen civile. Së fundmi, në kreun VI të projektvendimit janë propozuar rregullat që lidhen me mbikëqyrjen dhe kontrollin e procesit të regjistrimit për të siguruar transparencë dhe qasje të të gjithave palëve në çdo hap përgatitor apo të zbatimit të procesit, të tilla si vijon: e drejta e partive politike, organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara në procese zgjedhore, përfaqësuesit e shteteve të huaja të akredituar në Shqipëri, si dhe të medias, të njihen me të gjitha elementët e PER, për analogji siç parashikon Kodi me të gjithë sistemet e teknologjisë së informacionit që përdoren në zgjedhje, e kemi sjellë këtë propozim, veçanërisht gjatë proceseve të testimit operacional, kontrollit apo auditimit të saj. Referuar nenit 61 të Kodit Zgjedhor, mbikëqyrja dhe kontrolli i procesit, të veprimeve që do të bëjë KQZ gjatë regjistrimit të shtetasve që votojnë nga jashtë vendit dhe kanë paraqitur këtë kërkesë, do të duhet të verifikohet kohë pas kohe nga auditët teknikienë, proces i rregulluar në nenin 61 të Kodit Zgjedhor. Me kërkesë të partive politike, ose kryesisht të KQZ, mundëson auditim të pavarur të PER nga subjekte të specializuara. Ky projektvendim, siç ju thashë në fillim është bashkërenduar me palët, është publikuar në datën 23 shtator për konsultim publik. Kemi pasur disa reagime nga organizata të shoqërisë civile “Diaspora për Shqipërinë e Lirë”, “Komiteti Shqiptar i Helsinkit”, “Qëndresa Qytetare”, përfaqësuese të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

këshillit koordinues të diasporës. Po ashtu Partia Lëvizja Shqipëria Bëhet, si dhe Organizata KRIIK. Për sa më lart në këtë relacion siç referova, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe përgatitjen e listës së këtyre zgjedhësve”. Ju faleminderit!


Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Josifi! Faleminderit zyrtarëve të administratës! Atëherë fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Për procedurë, sa i përket shqyrtimit në parim të projektaktit fillimisht, sipas rregullores për funksionimin e Komisionit Rregullator, fjalën do ta kenë, me kërkesë kuptohet anëtarët e Komisionit Rregullator, më tej përfaqësuesit e partive politike, apo subjekteve të tjera të interesuara. Në rastin e shqyrtimit nen për nen, apo pikë për pikë të projektaktit, më së pari do t’u jepet fjalapërfaqësuesve të partive politike dhe subjekteve të tjera të interesuara, më tej u jepet fjala anëtarëve të Komisionit Rregullator. S’kemi diçka për procedurën?! Fillojmë me shqyrtimin e projektaktit, siç ju thashë, në parim e kanë së pari fjalën anëtarët e Komisionit Rregullator. Zoti Çaka!

Znj. H. Vukaj: Kishim kërkuar dhe ne fjalën për procedurë...

Znj. I. Nano: Le të vijojë zoti Çaka, pastaj vijoni me rradhë.

Z. D. Çaka: Faleminderit zonja Nano, ju faleminderit të gjithë të ftuarve për pjesëmarrjen dhe përfaqësuesve të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për relatimin. Doja ta nisja nga një pikë e fundit që zonja Josifi relatoi,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

më shumë në pjesën e procedurës, nja dy pyetje. Ju në fjalën tuaj cituat se keni bërë disa dëgjesa publike me aktorë dhe faktorë të këtij procesi dhe ka pasur edhe sugjerime të cilat kanë ardhur në forma të ndryshme pranë administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Një pyetje kisha, nga këto kërkesa ka pasur akomodime të tyre në draftin final që i është sjellë Komisionit Rregullator për shqyrtim?

Znj. I. Nano: Po, zonja Josifi!

Znj. J. Josifi: Faleminderit për pyetjen! Po, ka pasur akomodim të opinionëve të sjella. Organizata “Diaspora për Shqipërinë e Lirë”, solli propozimet e saj për përfshirjen e parimeve të përgjithshme mbi të cilat duhet të mbështetet procesi i regjistrimit dhe votimit të zgjedhësve nga jashtë vendit. Parime të cilat nuk ishin të përfshira në draftin tonë fillestar. Fillonim me “rregulla të përgjithshme”, që në fillim të projektaktit. Menduam, e pamë me vend që të përfshiheshin parimet e propozuara nga kjo organizatë, sa i takon procesit të regjistrimit. Do të konsiderojmë, do të marrim në shqyrtim, kur të përgatisim dhe të paraqesim përpara jush projektaktin për votimin, parimet e tjera që lidhen me votimin, të sjella nga kjo organizatë. Kemi pasur opinion nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i cili për shkak të draftit të parë që ne qarkulluam për konsultim, kishte koment për sa i takonte kushteve dhe dokumentacionit që kërkohet për të provuar adresën nga jashtë vendit. Siç ju thashë, në këtë projektakt nuk jepet lista e detajuar e këtij dokumentacioni, e cila do të propozohet me një akt tjetër, prandaj dhe ky do të jetë një diskutim që do të bëhet dhe do të shqyrtohet në aktin e rradhës. Po ashtu “Qëndresa Qytetare”, kishte komente sërish për sa i takon listës së dokumentacionit që provonin adresën. Duke u shprehur...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Çfarë janë komente për listën e dokumenteve, do të jenë në një akt tjetër. Për këtë akt që kemi sot në shqyrtim.

Znj. J. Josifi: “Qëndresa Qytetare” lidhur me këtë akt, pra rregullat e regjistrimit, rekomandon ndryshimin e pikës 3, të Kreu III, të projektvendimit si vijon “Nëse këto të dhëna janë të sakta dhe përputhen me të dhënat që regjistri kombëtar ka për këtë zgjedhës, atëherë Platforma Elektronike e Regjistrimit, do të duhet ta regjistrojë në mënyrë automatike këtë shtetas, si zgjedhës nga jashtë vendit”. Ne e kemi reflektuar këtë pjesërisht në projektvendim, pasi fillimisht në draftin e qarkulluar ishte parashikuar vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, rast pas rasti për regjistrimin e çdo shtetasi. Ndërkohë e kemi lënë këtë, nuk e kemi reflektuar plotësisht, kemi lënë një kohë, kemi lënë elementin “njeri”, në shqyrtimin e kërkesës për regjistrim, pasi gjithësesi do të duhet të shqyrtohet dokumentacioni i paraqitur. Ndaj në projektvendimin për sa i takon rregullave të regjistrimit, kemi hequr vendimin e Komisionerit dhe do të diskutojmë në projektaktin e rradhës, të shqyrtojmë komentën që lidhet me deklarimin e adresës. Ndërkohë në lidhje me saktësinë e të dhënave dhe procedurën për korigjimin e pasaktësive në platformë, duhet të përcaktohet një afat i qartë dhe i arësyeshem. Ky afat është dhënë, sepse e ka dhënë vetë Kodi në fakt, 48 orët që zgjedhësi ka në dispozicion. Në lidhje me verifikimin e zgjedhësit, vijon “Qëndresa Qytetare” dhe sigurisë së platformës, ka sugjeruar që të përfshihen kërkesa të qarta teknologjike për përdormin e platformës, si dhe mekanizma alternativë për ata që kanë probleme me teknologjinë. Kjo nuk është reflektuar pasi ligji vetë ka përcaktuar që kërkesa bëhet në një platformë elektronike.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*


Znj. I. Nano: Zonja Josifi, këto i kemi në relacion, ndaj zoti Çaka donte çfarë është reflektuar e çfarë jo? Të lutem shkurt, nëse ka diçka tjetër ende.

Znj. J. Josifi: Jo, faleminderit!

Znj. I. Nano: Zoti Çaka, mbaruat?

Z. D. Çaka: Jo dhe një pyetje është në vazhden e .. që më ngacmoi vetë zonja Josifi, për pjesën e akteve të tjera që do të vijnë. Meqenëse ne sot po hapim siparin e një procesi shumë të rëndësishëm dhe të shumkërkuar prej kohësh nga një pjesë e madhe e faktorëve, aktorëve, por dhe e qytetarëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do të doja të kisha dhe një pyetje, po njëkohësisht edhe një kërkesë karshi administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Komisionerit. Duke qenë se ky është vetëm akti i parë që ne kemi për shqyrtim, miratim dhe kuptohet që kërkohen edhe akte të tjera që lidhen me procesin e votimit, numërimit, administrimit, përfshirjes së votave në rezultatin përfundimtar në qarqe, etj... Pra, një pyetje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, administrata a po vazhdon dhe a jemi të gatshëm për të respektuar të gjitha këto afate, të cilat ne na ka vendosur Kodi Zgjedhor, me aktet vazhduese? Kjo është dhe një formë kërkesë nga ana ime që të punohet sa më shpejt dhe për pjesën tjetër të akteve, që të na sillen sa më shpejt për miratim, jo vetëm pra, si një detyrim ligjor që Kodi Zgjedhor i ka vendosur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me një afat, por edhe për ta implementuar sa më shpejt votën e votuesve nga jashtë shtetit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Duhet të keni një gjë para sysh që ndryshimet e Kodit Zgjedhor, kanë autorizuar në mënyrë eksplicite vetëm Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve për të propozuar akte për votën e emigrantit. Pra, ju lutem, përcilljani Komisionerit këtë kërkesën time,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

nuk di si mund të konsiderohet. Sa më shpejt të vijmë dhe aktet e tjera, të plotësojmë të gjithë kuadrin ligjor që të mundësojmë në zgjedhjet e 2025 votën e emigrantit, faleminderit.


Znj. I. Nano: Zonja Josifi, përgjigjen e pyetjes!

Znj. J. Josifi: Po, jemi duke punuar për aktet e tjera. Ne e kemi bërë planin tonë të punës sa i takon hartimit të projektakteve dhe kohës së paraqitjes së këtyre akteve për shqyrtim në Komisionin Rregullator, matricë e cila ju është dërguar dhe ju për mendim në fillim të muajit shtator. Ne jemi të angazhuar të respektojmë të gjitha afatet, duhet vetëm të kuptojmë që ndryshimet në Kodin Zgjedhor, sa i takon votës së diasporës, kanë ndodhur shumë, shumë rishtazi. Që të nesërmen e hyrjes në fuqi të ligjit, ne kemi qenë në punë, po shohim modelet për të sjellë përpara jush produkte që janë sa më korrekte të realizueshme, në përputhje me Kodin, por dhe të thjeshta për zgjedhësit nga jashtë.

Znj. I. Nano: Brenda afateve domosdo, por sa më shpejt brenda afateve. Kolegë, diskutim në parim? Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Faleminderit që qëndruat djathtas! Është “right”, në fakt dhe uroj me zemër që dhe ky proces të jetë “right” dhe të jetë ogur i mirë për të gjithë pritshmëritë e votuesve tanë nga jashtë. Dëgjova me vëmendje përfaqësuesen e administratës, dëgjova transkriptin që ajo relatoi. Prisja në fakt që, sot për hir të rëndësisë të këtyre akteve, në atë tryezë të ishte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Por, është në vlerësimin e tij dhe mbetet në vlerësimin e tij të jetë, apo jo prezent sipas mënyrës që të ketë menduar ecurinë e këtij procesi. Megjithatë në parim, unë do të ndalesha

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

dhe do të shënjoj dy-tre fjalët e mia për hir të rëndësisë që do të marrë ky proces dhe votës tonë dedikuar këtij procesi. Ky draft është vërtet një pikënisje pa dyshim me një rëndësi të veçantë historike në fushën e zgjedhjeve. Sot çelet sipari i rrjedhës normuese të mundësimit të ushtrimit të së drejtës së votës së shtetasve shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Që në krye të herës, pikërisht për hir të kësaj rëndësie më duhet të shpreh dakordësinë në parim për këtë akt dhe çdo akt tjetër që do të pasojë në funksion të realizimit të procesit të votimit në mënyrë konstruktive, të lehtë dhe gjithpërfshirëse për gjithë shtetasit shqiptarë, zgjedhës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Jam e gatshme, të nderuar kolegë, të nderuar pjesëmarrës në sallë, apo të të gjithë të interesuarve që na ndjekin me vëmendje sot. Jam e hapur dhe e gatshme për çfarëdolloj diskutimi, vlerësimi, dinamike proceduese si të jetë e nevojshme, vetëm që ky proces të bëhet i mundur, i realizueshëm dhe të shënohet si histori suksesi në këto 30 vite. Së treti, jam e hapur dhe e gatshme, dhe e bëj publike që në pararendje, se kam bindje të plotë që parimet që duhet të udhëheqin këtë akt e të tjerat që duhet ta pasonin njëherazi, pra, duhet të ishte një paketë sot dhe jo një akt i veçuar, duhet të jenë: - Së pari, procesi i votimit nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të duhet të jetë masiv. Pra, duhet t'i jepet mundësia gjithkujt pa përjashtim të regjistrohet dhe të votojë për zgjedhjet e vitit 2025. - Parimi i dytë, procesi duhet të jetë i lehtë, i aksesueshëm dhe i kuptueshëm, i zbatueshëm, pa pengesa, pa burokraci, pa ngërçe e duke marrë në konsideratë të gjithë kategoritë e emigrantëve. Ata legalë, jolegalë. Ata të ikur për arsye ekonomike. Ata të ikur për arsye politike. Ata pa adresë. Ata azilantë, apo në çfarëdolloj forme të gjendjes sociale që ndodhen, apo grupmoshe përfaqësimi, të rinj, apo të vjetër në moshë. Ndaj këtu gjej me vend të ftoj, në këtë proces vendimmarrës të gjitha palët politike, të gjithë aktorët e tjerë të interesuar pjesë e shoqërisë civile, të kenë akses e të shprehin mendimet e tyre pa ekuivok, në të mirë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

të mundësimin të votimit nga jashtë të të gjithë shtetasve shqiptarë që ndodhen në territore të huaja. Sipas censusit, marr të dhënën e fundit të publikuar, janë afro 2 200 000 shtetas shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Jo pak të nderuar, kështu që të gjithë meritojnë të kenë mundësinë e realizimit të kësaj të drejte kushtetuese të shumpritur dhe ndaj të cilëve kemi detyrimin të ofrojmë rregulla dhe akte nënligjore që do të mund të ndihen të barabartë me shtetasit e tjerë shqiptarë me banim brenda vendit, duke evituar çdo eventualitet që do të pamundësonte të drejtën e ushtrimit të votës. Këto ishin pikëpamjet e mia në parim, për hir të rëndësisë dhe cekjes fillestare që po i bëj këtij akti. Për sa i përket procedurës, ndaljes në teknikë legislative, në përmirësimin e aktit, në krendryshime, ndryshime, plotësime, fjalën do ta marr sa herë të jetë e nevojshme për konsolidimin dhe integritetin e aktit, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Po, faleminderit zonja Kryetare! Në vijim dhe të fjalës së koleges Vukaj, për të mos kaluar në përsëritje. Unë mendoj që ky proces duhet të udhëhiqet nga dy parime kryesore. Së pari, gjithëpërfshirja dhe së dyti, jo vetëm lehtësia dhe thjeshtësia, por dhe qartësia. Ju relatuat projektaktin dhe realisht mua mu duk i komplikuar, shumë i komplikuar. Unë do të preferoja dhe sugjeroja, që në aktet në vijim, administrata të përgatisë mundësisht një paraqitje grafike, një “demo” një paraqitje vizuale se si do të mund të kryejë gjithë këto procese shtetasi shqiptar që ndodhet jashtë shtetit. Së pari, si do të mund të regjistrohet dhe sigurisht në aktet në vijim se si do të mund të votojë nga atje ku ndodhet, paraprakisht. Së dyti, për procedurë! Në nenin 24 të Kodit Zgjedhor, pika 5 parashikohet që “Procedurat e detajuara të votimit nga jashtë vendit miratohen me akt normativ të Rregullatorit,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

me propozimin e Komisionerit, brenda 90 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”. As në relacion, as në projektvendimin e propozuar për miratim, unë nuk e gjej emrin e Komisionerit. Përpos në relacionin që ju keni paraqitur këtu, kemi tre propozues, Jona Josifi, Drejtorja e Votimit nga Jashtë, Madalena Koja, Drejtorja e Ligjshmërisë, Majlinda Çelmeta, Sekretare e Përgjithshme, në mungesë dhe me urdhër. Ndërkohë që Kodi Zgjedhor, paracakton që propozimi të jetë i Komisionerit, do të duhej të ishte këtu e nderuar. Kështu që në draftin përfundimtar sugjeroj që ta sillni këtë, sepse është detyrim i Kodit Zgjedhor. Pastaj nëse Komisioneri e vlerëson të vijë këtu vetë, ta prezantojë, apo të shkojë në televizione dhe ta bëjë me paraqitje grafike, ndërkohë që këtu na paraqitet një draft i komplikuar, një narracion shumë i komplikuar, vetëm me fjalë, është në zgjedhjen e tij, por detyrimin e ka që ta paraqesë këtë në bazë të nenit 24, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Së dyti, ju relatuat që ju keni bërë me dije palëve të interesuara. Jo më larg se dje, mos gaboj, sot na ka ardhur nga shoqëria KRIIK, një material, propozim, sugjerim. Më ra në sy diçka, fakti që shoqëria, Organizata KRIIK është njohur vetëm në datën 17, ora 16:14 me rendin e ditës për zhvillimin e mbledhjes. Ndërkohë që ju, të nderuar, relatuat se në datën 23 shtator, keni paraqitur projektaktin e parë për dhënie mendimi. Ndërkohë, ne na është risjellë, pra njoftimi për vënien në lëvizje të Komisionit Rregullator, na është sjellë me email zyrtar në datën 8 tetor. Nuk do të ishte e udhës që për hir të transparencës, siç kemi vepruar deri tani, që në momentin që bëhet njoftimi për vënien në lëvizje të Rregullatorit, të gjithë palëve të interesuara, përfshirë partitë politike dhe organizatat e ndryshme që janë të interesuara në këtë proces zgjedhor, t’ia dërgonit draftin me gjithë aktet e mbledhjes? Sepse nuk më rezulton. Nga ana tjetër, unë gjej shumë propozime dhe sugjerime të Organizatës KRIIK me të cilat unë ndaj, pothuajse ekzaktësisht të njëjtin mendim, të cilat nuk janë reflektuar në draft. Në momentin që ne do të shqyrtojmë pikë për pikë çdo parashikim, unë

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

sigurisht rezervoj të drejtën të bëj propozimin përkatës. Një nga elementët më të rëndësishëm të procesit të regjistrimit është procesi i identifikimit të zgjedhësit. E gjeta të paqartë në draftin tuaj se si do të identifikohet. Ka bërë një propozim konkret, një sugjerim konkret se si do të kryhet procesi i identifikimit të zgjedhësit, në mënyrë që të shmanget çdo manipulim. Do të kryhet manualisht, apo automatikisht? Nuk më rezulton të jetë e qartësuar kjo në draft. Kush do ta bëjë? Do ta bëjë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, do ta bëjë platforma elektronike, apo do ta bëjë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile? Do të duhet ta qartësojmë, ne së pari që do ta miratojmë dhe së dyti ta qartësojmë dhe për publikun dhe për regjistruuesin. Kjo e gjitha në kuadër të transparencës. Së treti, në lidhje me matricën e projektakteve që ju na keni dërguar, mos gaboj në fillim të muajit shtator, ju keni parashikuar një projektakt sipas parashikimit të nenit 24, pika 4 të Kodit Zgjedhor “Për përfshirjen për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, procedurave të zakonshme të votimit”, akt i cili është parashikuar nga ligjvënësi të miratohet me jo më pak se katër anëtarë, pra kërkon shumicën e cilësuar nga ne si organ rregullator. Ju kur keni menduar ta paraqesni këtë projektakt, në fillim të procesit, apo në fund të procesit? Në gjykimin dhe në vlerësimin tim, akti i cili duhet të çelte siparin e këtij procesi, minimalisht tregon vullnetin edhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por dhe ne të pestëve si organ rregullator, si organ drejtues i KQZ-së do të duhej të shprehemi paraprakisht që në fillim. Një tërheqje vëmendje, jemi shumë vonë me afatet. Ligjvënësi ka parashikuar që brenda 90 ditëve, brenda hyrjes në fuqi të këtij ligji, mos gaboj ligji, mos gaboj, ligji ka hyrë në fuqi më datë 14, 15 gusht, afat i cili përkon me datën 15 nëntor, do të duhet të kemi miratuar të gjithë paketën ligjore. Ndërkohë, ne kemi në dorë vetëm këtë aktin e parë. Nuk kemi aktin për listën e detajuar të dokumentacionit të zgjedhësit. Te lista e detajuar ka dy kategori dokumentash. Një kategori dokumentash të cilat verifikojnë identitetin e votuesit nga jashtë dhe një kategori

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*


dokumentash të cilat verifikojnë dhe vërtetojnë adresën e banimit nga jashtë vendit. Përpos kësaj do të duhet të kemi paraprakisht një akt, me anë të të cilit të përcaktojmë në mënyrë të detajuar rregullat, procedurat e votimit nga jashtë vendit, si dhe procedurat për administrimin, numërimin dhe tabulimin e rezultateve. Jemi shumë vonë, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj! Edhe unë dy fjalë në parim... prisni përgjigje nga zonja Josifi, apo ta marrim si tërheqje vëmendje për...

Z. M. Çakaj: Edhe mund të japë një përgjigje për ato të cilat konkretisht pyeta.

Znj. J. Josifi: Faleminderit për pyetjen, thjesht për transparencë të procesit të ndjekur dhe qartësinë që ju përmendët. Matrica e projektakteve, po është dërguar që në fillim të muajit shtator në datën 4 me email, për mendim. Në këtë matricë, po e lidh me pyetjen tuaj për projektaktin që parashikohet në nenin 24, pika 4 ku thuhet se “Rregullatori duhet të marrë vendim me të paktën 4 vota “pro” për përfshirjen për herë të parë të votimit nga jashtë vendit në procedurat e zakonshme të votimit. Në zgjedhjet vijuese, votimi nga jashtë vendit bëhet automatikisht pjesë përbërëse e procedurave të votimit”. Ne kemi menduar ta sjellim këtë projektakt si të fundit në rradhë me qëllimin që të kemi të ngritur ndërkohë, të gjithë kuadrin rregullator dhe infrastrukturor dhe në fund të sjellim këtë propozim përpara jush. Pra, në momentit që çdo gjë është gati dhe është konsultuar dhe finalizuar do të sjellim për propozim këtë projektakt. Ndërkohë, sa i takon konsultimit publik, ju përmendët mendimet e ardhura nga Organizata KRIIK, në fakt ne kemi publikuar draftvendimin në datën 23 shtator. Në këtë ditë, fillimisht ky draft ju është dërguar nëpërmjet postës elektronike, juve si Komision Rregullator, i është dërguar organizatave të shoqërisë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

civile me email, ju është dërguar medias me email dhe ju është dërguar edhe partive politike. Në datën 30 shtator Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka zhvilluar edhe një diskutim online me përfaqësues të diasporës, ku kishte dhe përfaqësues të Organizatës KRIIK, nga ku janë marrë mendime të cilat janë të cituara në relacion. Njësoj ka qenë mendimi nga Organizata “Diaspora për Shqipërinë e Lirë”. Pra, në atë moment, ashtu si Organizata “Qëndresa Qytetare” në këtë takim. KRIIK kishte..., pavarësisht se ishte njohur me draftin shtatë ditë përpara, kishte pyetje përgjatë takimit dhe jo komente të cilat tha se do t’i dërgonte në një moment të dytë. Pra, pasi të ishte sqaruar për pyetjet gjatë takimit, me shkrim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ashtu sikundër ju thatë që Komisioneri vuri në lëvizje Komisionin Rregullator në datën 8 tetor, në këtë moment nuk ju dërgua njoftim për materialet ...

Z. M. Çakaj: Pra, nuk ja keni dërguar atë të rishikuarin në datën 8 tetor KRIIK-ut?

Znj. J. Josifi: Ja, atë po thoja, ju lutem! Në datën 8 tetor kur u vu në lëvizje Komisioni Rregullator dhe menjëherë do të njoftoheshin të gjitha palët, sikundër bëhet njoftimi për mbledhjet e Rregullatorit, duke u shoqëruar me dokumentacionin përkatës, menjëherë ne morëm informacionin që mbledhja e Komisionit Rregullator nuk do të duhej të zhvillohej. Ne për arsye të ndryshme, nuk do të kishim një mbledhje ato ditë dhe do të prisnim kur do të njoftohej mbledhja e Komisionit Rregullator. Kur u njoftua, atëherë bëmë me dije të gjithë palët për draftin që do të paraqitej në seancë. Sot në datën 18 tetor, në orën 08:02 të mëngjesit, na kanë ardhur me email, mendimet me shkrim të Organizatës KRIIK. Në gjykimin tonë, ato janë gjithnjë të mirëpritura, aq më tepër nga një organizatë që është shumë aktive sa i takon mbikqyrjes së proceseve zgjedhore dhe çdo aspekti të punës së administratës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ashtu si dhe të organeve drejtuese. Në këtë rast

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*


ne i kemi lënë kohën e mjaftueshme, mendojmë ne, për të sjellë mendime, sugjerime me shkrim, verbalisht, me çfarëdolloj forme, pra nga data 23 shtator deri në datën 18 tetor. Pra, gati një muaj, jo vetëm në rastin e Organizatës KRIIK, por për të gjitha palët e njejta gjë. E njejta gjë dhe për subjektet zgjedhore, e njejta gjë vlen për mediat, e njejta gjë vlen për çdo organizatë tjetër.

Z. M. Çakaj: Qartë! Ju pranoni që nuk e keni dërguar materialin, nga ajo çfarë konfirmoni paraprakisht. Tani në lidhje me përmbajtjen e propozimeve konkrete. Besoj i keni lexuar ato propozime, sugjerime konkrete. Keni ndonjë koment për këto propozime të fundit, se kanë të bëjnë me procesin. Procesi është i të gjithë shqiptarëve, nuk është vetëm i KQZ-së! Pra, do të duhet të kontribuojmë që të gjithë për një proces sa më të qartë, sa më të thjeshtë, sa më transparent dhe sa më të realizueshëm. Unë personalisht gjej shumë nga ato propozime të bazuara. Ndërkohë që nuk janë reflektuar në draft. Do të doja të kisha dhe një koment për këto propozime konkrete.

Znj. I. Nano: Më fal, propozimet konkrete janë për nene konkrete, apo jo? Unë nuk mendoj se kanë ardhur... ne na është dërguar drafti që në datën 8. Nuk besoj se sot në 8 të mëngjesit janë reflektuar. Nuk kemi marrë draft tjetër ne!

Z. M. Çakaj: Propozimi konkret nuk është për një nen konkret. Një nga propozimet konkrete psh është që unë ndaj ekzaktësisht të njejtin mendim, do të duhej që e gjithë paketa ligjore e akteve për votimin nga jashtë, të ishte e sjellë tashmë, pranë Komisionit Rregullator, ose pranë të gjithë aktorëve. Të ishte bërë publike dhe “hajt të konsultohemi, të bëjmë një paketë ligjore të plotë”. Ky është një propozim konkret dhe është parim. Është mëse në parim!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Dakord! Pyetja është, keni arritur të reflektoni diçka nga momenti që keni marrë sot në 8 të mëngjesit email-in nga KRIIK-u, apo mund të na thoni gjatë shqyrtimit të aktit sot, diçka lidhur me këto sugjerime?

Znj. H. Vukaj: Ose çfarë parashikohet të implementohet sot, po nga ju, në ndërgjegjen e pastër që “shiko se KRIIK-u ka të drejtë për shumë gjëra”, pothuajse për 80-90 % të gjërave që shtron. Pra, jep garanci KRIIK-u dhe ngre pikëpyetje absolutisht të qëndrueshme. Pra, jeni koshientë që këto duhet të përfshihen sot? Ndërkohë në përvojën tonë katër vjeçarë, ne kemi pasur raste të cilat për hir të konstruktivitetit dhe integritetit të një akti, ne e kemi çmuar që të vendosen edhe para se të kalonim në mbledhje. Pra, ju si administratë dhe ne kemi pasur mirëkuptimin që t’i pranojmë, për hir të të mirës së përgjithshme.

Znj. J. Josifi: Sa i takon pyetjes së parë që ka ardhur edhe si rekomandim i Organizatës KRIIK për të sjellë përpara Komisionit Rregullator paketë të plotë dhe jo akte të një pas njëshme. Ne kemi zbatuar dhe do të zbatojmë dhe jemi duke zbatuar parashikimet e bëra në Kodin Zgjedhor për sa i takon miratimit, ose paraqitjes së akteve për miratim. Nuk kemi dalë jashtë afateve. Kodi nuk ka thënë duhet një paketë e plotë, apo akte të një pas njëshme. Kështu e kemi menduar. Mund të kishte qenë edhe ajo një alternativë, ne jemi duke punuar ditë pas dite. Sa i takon mendimeve të tjera, ne nuk i kemi reflektuar në projektvendimin që ju keni sot përpara të printuar, por s’ka asnjë problem për ne t’i shqyrtojmë ato gjatë seancës së sotme, një nga një gjatë diskutimeve konkrete për nene. Unë mund t’i marr edhe me rradhë tani, por në mendimin...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Nuk është momenti për t'i marrë me rradhë tani, nuk jemi nen për nen. Pra, nuk janë reflektuar, sepse sot në mëngjes kanë ardhur. Kjo është përgjigjja e pyetjes që kërkonit besoj! Po, një pyetje zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Do të doja të dija, platforma elektronike e regjistrimit, s'po e them të gjithë akronimin për shpejtësi dhe shkurtësi, edhe pse duhet i gjithë akronimi. Keni paraqitur ju një demo përpara palëve të interesuara, subjekteve, shoqërisë civile, medias, sepse më shumë gjërat ne i kemi mësuar nga media se sa na janë bërë prezent ne si Komision Rregullator, edhe pse jemi hallkë e domosdoshme e këtij procesi normues.

Znj. J. Josifi: Ka pasur vetëm një propozim në nivel teknik të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në takimin e zhvilluar me grupin e dialogut të ngritur në kuadër të punës së komisionit të posaçëm për reformën zgjedhore, në datën 22 maj të vitit 2024. Ishte një propozim teknik, asnjë demo, pra një prezantim në power point, e thënë kështu thjeshtë, se si mendonim ne që, do të mund të ishte regjistrimi. E para, të ishte elektronik dhe jo në letër. Pra, që zgjedhësi të dërgonte shkresa, letra me postë në KQZ, flas vetëm për regjistrimin, por të ishte elektronik. Kishte një propozim tonin aty...

Znj. H. Vukaj: A ka një akt konkret që ka miratuar ekzistencën dhe funksionimin e platformës elektronike, pra krijimin e platformës elektronike?

Znj. J. Josifi: Jo nuk ka një akt, përveç faktit që kjo platformë, ne e konsiderojmë aktin që e ka krijuar, ose që ka stipuluar krijimin e tij, vetë ndryshimet e Kodit Zgjedhor, të cilat kanë sqaruar këtë fakt, më lejoni vetëm një moment ta.., po neni

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

25, pika 5, fjalia e dytë, “KQZ-ja krijon, mirëmban dhe përditëson platformën elektronike për regjistrimin e kërkesave të zgjedhësve që dëshirojnë të votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”...

Znj. H. Vukaj: Pra, nga sa lexuat ju, askund nuk stipulohet dhe sixhillohet një paketë dhuratë e një platforme në ajër. Pra, krijohet në KQZ, ndërkohë që këtu në draftin e paraqitur nga ju, kemi një platformë që të jep përshtypjen që ekziston dhe ne tani po sixhilojmë dhe timbrojmë ato që ju mund të kishit krijuar. Ndaj unë me të drejtë ngrita këtë pyetje, sepse ne nuk jemi në dijeni të ekzistencës që të kemi krijuar ne si Rregullator një platformë, ashtu sikundër kemi krijuar në rastin e paisjes elektronike të identifikimit (PEI) dhe paisjes elektronike të votimit (PEVN).

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Z. M. Çakaj: Ta bëjmë më thjesht pyetjen. A mendoni ju si administratë se ka nevojë të normohet siç parashikon dhe neni 25, pika 5, e Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se KQZ krijon, përditëson, mirëmban një platformë elektronike të regjistrimit të votuesve nga jashtë vendit? A mendoni ju se ka nevojë për një akt me karakter rregullator, me anë të të cilit të përcaktohen karakteristikat teknike si dhe rregullat për krijimin, mirëmbajtjen, auditimin, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të shtetasve? Mendoni se ka nevojë për një akt, duke marrë në analogji dhe sistemet elektronike të tjera, të cilat i kemi normuar me akte të ngjashme, pra si PEI-n ashtu dhe PEVN, si e gjykoni ju?

Znj. J. Josifi: Ne kemi gjykuar që nuk kishte nevojë për një akt të tillë. Për sa kohë krijimi, mirëmbajtja është parashikuar në ligj dhe shprehimisht ligji nuk ka dhënë ndonjë autorizim ligjor, në pikën ku flet për këtë platformë elektronike të regjistrimit, për këtë fakt. Megjithatë kjo nuk na pengon, sigurisht nëse e gjykoni, e vlerësoni, të hartojmë një projektakt për këtë qëllim. Ne nuk e kemi parë kështu, pra nuk kemi vlerësuar se do të kishte një akt nënligjor.

Znj. H. Vukaj: Ju administrata apo Komisioneri? Sepse Kodi Zgjedhor është i qartë në këtë pikë, që duhet dhe duhet të marrë rëndësinë e pajisjeve të tjera elektronike apo platforma elektronike që janë zhdërvjelltësuar këtu për hir të procesit, risive të procesit.

Znj. J. Josifi: Nuk e gjykoam që do duhet të kishte një akt nënligjor për...

Znj. H. Vukaj: Ju si administratë apo Komisioneri?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. J. Josifi: Komisioneri për kërkesat dhe ne si administratë. Komisioneri për kërkesat teknike të platformës, megjithatë, menjëherë mund të përgatisim një të tillë.

Znj. H. Vukaj: Propozimi është i Komisionerit apo është propozimi juaj?

Znj. J. Josifi: Propozimi është i Komisionerit.

Znj. H. Vukaj: Po pikërisht pra, ju nuk gjykoni.

Z. M. Çakaj: Një gjë të fundit, në nenin 25, pika 11 përcaktohet, të Kodit Zgjedhor, parashikohet që auditët teknicienë të miratuar sipas nenit 61 të këtij Kodi kanë të drejtë të kryejnë verifikimin e veprimeve të realizuara nga KQZ për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Që do të thotë do të auditohet, pra auditët teknicienë të miratuar në bazë të nenit 61 të Kodit Zgjedhor, do të auditojnë posaçërisht PER-in. Tani, që të auditojnë PER-in, a do të duhej të kemi një akt i cili e krijon, e mirëmban? Caktuam ca rregulla për organizimin, funksionimin, administrimin, përpunimin e të dhënave, sepse nëse krijohet PER-i, unë gjykoj që do të duhet të krijohet me një akt, s'ka rëndësi, të KQZ-së, mund të jetë i Komisionerit, mund të jetë i Rregullatorit, por do të duhet të krijohet PER-i, do të duhet të përcaktohen disa rregulla, disa parime, disa kritere, mbi të cilat do të kryejnë dhe detyrat auditët teknicienë. Unë mendoj se i shërben dhe e ndihmon procesin, posaçërisht neni 11 këtë ka parashikuar, kështu që do të dëshiroja ta vlerësonit në këtë prizëm.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Znj. Josifi, atëherë lidhur me këtë që sapo diskutuan kolegët, duhet t'ia transmetoni Komisionerit, të vlerësojë mundësinë e hartimit të një projektvendimi. Duhet parë nëse është me karakter normativ. Zoti Çakaj hapi mundësinë qoftë me akt tonin, qoftë me akt të Komisionerit, të vlerësohet.

Z. M. Çakaj: Kur të vijë momenti konkret ne mund të bëjmë dhe një parashikim në këtë draft. Pra, KQZ-ja krijon të njëjtën gjë, është shumë e rëndësishme të përcaktojmë disa rregulla, në mënyrë që t'i krijojmë mundësinë audituesve ta auditojnë këtë.

Znj. I. Nano: Dakord. Meqë jemi te diskutimi në parim, mua nuk më mbeti shumë, si anëtare dhe Kryetare e Komisionit Rregullator, për të thënë. Normalisht, sot kemi vetëm aktin për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe listën e zgjedhësve. Sikundër dhe kolegët e thanë më parë ky është akti i parë, në vijim do të kemi akte të tjera, të cilat do të mund nëpërmjet tyre dhe veprimtarisë administrative të KQZ-së, po dhe institucioneve të tjera të përfshira në këtë proces, të materializojnë votën e shqiptarve nga jashtë vendit dhe pa dyshim është një proces shumë i rëndësishëm. Padyshim kam ndjenjën më të lartë të përgjegjësisë që jam pjesë e këtij procesi, gjithashtu dhe kënaqësinë që jam pjesë e këtij procesi. Kështu që do mbyll diskutimin tim në parim. Zoti Çela keni diçka në parim? Atëherë kalojmë me subjektet nëse keni diçka në parim? Po.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po, faleminderit. Franci Nuri, përfaqësues i përhershëm i Partisë Demokratike.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Zoti Nuri, ndjesë nuk ju drejtova me emër, pra z.Nuri, përfaqësues i Partisë Demokratike.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Përfaqësues i përhershëm i Partisë Demokratike në KQZ. Atëherë, faleminderit dhe njëherë për mundësinë! Në parim Partia Demokratike është pro padryshim votës së emigrantëve, votës së shqiptarve, votës së diasporës, votës së shqiptarve me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për të përfshirë të gjithë kategoritë e mundshme të shtetasve shqiptarë që aktualisht ndodhen në emigrim dhe e kanë pasur vitet e fundit të pamundur që të votojnë gjatë zgjedhjeve të shkuara dhe ndryshimet e fundit ligjore në parim e mundësojnë këtë gjë. Pra, në parim jemi plotësisht dakord. Ajo që ne kemi, është se ne kemi disa vërejtje dhe disa sugjerime. Duke parë këtë draft fillestar kemi disa shqetësime që duam t'i ndajmë, në parim gjithmonë. Janë tre elementë kryesorë. I pari, ne duam që, si parti politike, si subjekt zgjedhor jemi të interesuar që të ketë një masivizim të pjesëmarrjes, t'u jepet mundësia sa më shumë qytetarëve shqiptarë që jetojnë dhe janë me banim jashtë shtetit, që të regjistrohen. Të regjistrohen në këtë platformë dhe të marrin pjesë në votimet në vitin 2025. Nga ana tjetër duam që, elementi i dytë, që të ketë një thjeshtim akoma më tepër të procedurave që janë të parashikuara në këtë draft. U tha dhe me të drejtë dhe nga anëtarët e Rregullatorit, që duken të komplikuar dhe nuk janë aq të thjeshta sa një qytetar me njohuri të zakonshme do të mund t'i përvetësonte, në mënyrë të thjeshtë dhe në aspektin praktik, të ishte e lehtë kryerja e këtij procesi. Por nga ana tjetër nuk duhet të harrojmë që duhet të ketë edhe "safeguards", të ketë garanci që çdo gjë të jetë transparente dhe të eci në shinat dhe në kornizat ligjore. Një shqetësim tjetër që, domethënë, për ta ilustruar pak pikën e parë të masivizimit, është fakti se në projektdraft që ne na është vënë në dispozicion, parashikohet për shembull, që zgjedhësi shqiptar me banim jashtë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

shtetit të regjistrohen në këtë platformë elektronike, tek PER-i vetëm me kartë identiteti të vlefshme apo pasaportë të vlefshme. Ne patëm rastin dhe në zgjedhjet e shkuara, në Himarë, po dhe në zgjedhjet e mëparshme, në procese të tjera zgjedhore që u ngrit dhe shqetësimi i ndikimit të zgjedhësve me karta apo me pasaporta të skaduara. Në vetvete, si afat vlefshmërie, këto janë dokumenta plotësisht të vlefshme për në gjykimin dhe në vlerësimin tonë për efekt të identifikimit se kush është zgjedhësi, përderisa janë dokumenta që kanë elementë biometrikë, kanë elementë të një sigurie të lartë etj., etj., dhe e gjykojmë që nuk duhet kufizuar tek dy dokumenta në radhë të parë, por mund të përfshihen dhe dokumenta të tjerë. Praktikrat më të mira në vendet perendimore njohin, për ta bërë pak më konkrete, e bëjnë të barasvlefshme edhe lejen e drejtimit, patentën e dikujt që disponon, e bëjnë të barasvlefshme për efekt identifikimi me pasaportën apo me kartën e identitetit. Megjithatë këto janë thjesht shembuj, i mbetet Rregullatorit pastaj dhe KQZ-së që t'i ilustrojë në detaje dhe të shohë mundësinë që të zgjerohen sa më shumë. Pra këto elementë që do të bëjnë të mundur regjistrimin e shtetasve shqiptarë në këtë platformë elektronike për mundësimin e votës së shqiptarve me banim jashtë shtetit. Gjithashtu një shqetësim tjetër ose sugjerim, ne e konsiderojmë të domosdoshme të ketë një propozim, një dispozitë specifike, hartimin e karakteristikave teknike të kësaj platforme, pra të PER-it dhe të rregullave për administrimin, regjistrimin, përpunimin, mbikqyrjen, pse jo dhe administrimin apo verifikimin e integritetit të kësaj platforme. Nga ana tjetër bashkohem me idenë që u ngrit dhe më herët sot se është e domosdoshme që të na vihet në dispozicion sa më parë një prezantim, një demo, mund ta quani si të doni, të procesit. Një proces, shikim vizual, qoftë edhe grafik apo elektronik se si bëhet procesi i regjistrimit me të gjitha hallkat e tij, nga pika një dhe deri në pikën e fundit të procesit, po dhe pse jo edhe të procesit të votimit, që ta kenë të gjithë aktorët dhe faktorët, në këtë proces që po organizohet,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

ta kenë të qartë, t'i kenë të gjitha gjërat të qarta. Për ta mbyllur në lidhje me këto çështje që sapo fola, do të ishte e udhës sikundër e tha dhe z. Çakaj në mos gaboj, që jo vetëm ne e gjykojmë që ka një vonesë në ardhjen e akteve, por do të ishte e udhës që të gjithë aktet nga ana e KQZ-së të kishin ardhur bashkë me një paketë të plotë. Në mënyrë ne të mund të njiheshim, ne të gjithë panoramën e akteve të ndryshme në këtë moment dhe të mos vinin njëri pas tjetrit, të vijë dhe të diskutojmë detaje që mund ta provonin procesin, po të kishim një panoramë të plotë të gjitha akteve në "emblok". Kjo do të ishte vërejtja dhe sugjerimi ynë drejtuar KQZ-së. Një pikë të fundit, një element të fundit dhe për arsye transparence, efekt transparence, të na vihej në dispozicion ose të bëhej publike pse jo, në një moment të dytë edhe emrat e stafit të KQZ-së që merren dhe do të merren me këtë proces. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit z.Nuri! Zonja Xhina.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Faleminderit! Atëherë e vlerësoj së tepërmi këtë hap të parë që po hidhet lidhur me projektaktin që na është paraqitur për miratim. Ky ka qenë detyrim i hershëm, patjetër që duhej realizuar, kështu që jemi me fat që jemi duke diskutuar votën e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Në vijim të diskutimit që ndoqa, i gjej me mjaft interes të gjitha mendimet që u hodhën. Në fakt u fol për vështirësitë, të platformës apo të aktit, por që në fakt nuk është se hasim vështirësi në ezaurimin e dispozitave që i takonin aktit, sa i takon idesë që duhet të kishte ardhur me një paketë, me projektakte. Në fakt do ta ndaja, sepse shoh që vetëm me një akt ne po hasim vështirësi duke thënë që është i paqartë dhe jo të kishim një paketë të plotë të projekligjit, projektakteve që do na vështirësonte ndarjen e mendimeve dhe ecurinë e procesit, do ta vështirësonte më tepër. Unë e përgëzoj stafin në vendosjen e parimeve, parimet na udhëheqin në leximin e draftit dhe

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

mendoj që parimet janë zbatuar më së miri në hartimin e këtij akti, pasi vetë parimi flet për lehtësi të procesit të votimit apo për elementët e sigurisë, kështu që në parim nuk kemi ndonjë diskutim për të bërë, jemi dakord. Pastaj ndalemi më tepër nen për nen, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit! Subjekte të tjerë të interesuar nga shoqëria civile? Tani është momenti, emailin tuaj nuk e ka lexuar kushdo, unë personalisht e pashë që kishte ardhur emaili gjatë mbledhjes, nëse ju keni diçka në parim gjithmonë për projektvendimin jeni e mirëpritur.

Znj. A. Male: Faleminderit!

Znj. I. Nano: Duke pasur parasysh faktin që keni qenë pjesë e tryezës konsultuese dhe projektakti i fundit ka dy ndryshime të rëndësishme: shtim parimesh dhe heqje e listës së dokumentacionit, pjesa tjetër është njëlloj si ka qenë.

Znj. A. Male: Atëherë më lejoni që të qartësoj fillimisht situatën e përshkruar paraprakisht nga administrata dhe anëtarët e Komisionit Rregullator. Projektakti është përcjellë për konsultim i shkruar në datën 23 shtator. Në datën 30 shtator ka pasur një konsultim online të zhvilluar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në të cilin ne kemi marrë pjesë dhe në fakt nuk kemi ngritur vetëm pyetje po në kuadër të të qenit një paketë të plotë dhe pyetjet kanë qenë për shkak të paqartësisë së aktit, domethënë, si do procedohet me PER-in, si do shkohet më tej me pjesën e regjistrimit apo identifikimit të zgjedhësve dhe të gjitha pikëpyetjet dhe sugjerimet janë marrë në konsideratë nga administrata e KQZ-së, e cila ka thënë se projektakti do të rishihet duke reflektuar të gjitha sugjerimet përkatëse dhe më pas do të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

riqarkullojë për konsultim. Pas kësaj mbledhje ne kemi marrë vetëm dje, në orën 4 e çerek njoftimin për zhvillimin e mbledhjes së sotme dhe për rrjedhim dhe të gjithë projektdraftin e rishikuar nga administrata. Për këtë arsye, rekomandimi me shkrim ka ardhur vetëm ditën e sotme në orën 8 të mëngjesit, nuk mundëm të ishte më shpejt. Padiskutim që ne shprehim të gjithë gatishmërinë tonë për të pasur konsultim edhe verbal me administratën dhe me ju për të gjitha propozimet që janë në projektakt, por ka hallka shumë të rëndësishme të cilat përtej faktit që do të duhej të ishin në një paketë të plotë paraprakisht të konsultuar nga të gjitha palët, ka edhe pika të cilat i takojnë këtij projektakti në veçanti dhe do duhet që në gjykimin tonë të shikohen nga administrata dhe ju, për t'u implementuar në funksion të përmirësimit të aktit dhe realizimit të një procesi, sigurisht sa më gjithëpërfshirës për momentin, por të arriret në pikëpamje të të gjitha standardeve të proceseve zgjedhore në tërësi.

Znj. I. Nano: Faleminderit! E kuptoj gjithë situatën, do ketë ndodhur diçka e orëve të vona të natës që ka ardhur emaili sot, gjithsesi e mbyllim diskutimin në parim dhe kalojmë në votimin në parim të projektvendimit “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”.

Kolegë kush është dakord në parim?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Me 5 vota pro miratohet!

Hapi i parë shumë i mirë! Kalojmë në diskutimin nen për nen. Kemi gjithë kohën e mjaftueshme, sot, nesër, pasnesër deri sa të miratojmë një akt për regjistrimin. Nuk

***Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

ka asnjë problem, se pashë njerëz që ishin të shqetësuar për kalimin e orës, ne jemi këtu për miratuar këtë akt. Nesër, pasnesër një akt tjetër, kurdo që të na vijë për ta shqyrtuar, për ta miratuar që të gjithë paketën ta kemi siç e theksova më herët, jo thjesht brenda afateve ligjore, por sa më shpejt, brenda këtyre afateve, 13-14 nëntorit. Siç ju thashë më herët, për procedurë, në këtë fazë do t'iu jepet fjala më së pari subjekteve, konkretisht partive politike se nuk kanë ende statusin subjekte zgjedhore dhe më tej anëtarëve të Rregullatorit për diskutimin, për propozime konkrete nëse do të kenë. në parim. Atëherë në mbështetje të nenit 20, pika 1 shkronja “dh”, neni 25, pika 1 dhe 12, neni 46, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi: Kreu I, Parime të përgjithshme... Po zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Në titull, në qoftë se e vini re, dhe në qoftë se konsultoheni me Kodin ose do biem dakord që do ta ndryshojmë sensin e Kodit ose t'i rrimë strikt në mënyrë literale Kodit, i cili thotë: “Regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” dhe pastaj kjo të inkorporohet në të gjithë tekstin. Unë kaq kisha si sugjerim fillestar.

Znj. I.Nano: Propozuesit, atëherë çfarë keni pasur parasysh apo keni patur “out of country voting” që e keni vendosur “zgjedhësit nga jashtë vendit”? Diku, në fakt në Kodin Zgjedhor znj.Vukaj ka të drejtë, diku përmendet “jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” diku përmendet “jashtë vendit”, ju çfarë keni pasur parasysh? Kreu, titulli i nenit është...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. H. Vukaj: Neni 24, që në titull përcakton Kompetencat e KQZ-së lidhur me votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Znj. J. Josifi: Ne e kemi vënë re këtë gjë në fakt edhe e kishim dhe ne dilemë në hartimin e projektaktit, por është vërtet kështu si thoni ju. Kodi në ndryshimet e tij i ka përdorur në fakt të dy terminologjitë, edhe “votimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, edhe atë “nga jashtë vendit”, psh. neni 24 që dhe ju cituat, në pikën 3, në të njëjtën pikë thotë edhe “jashtë territorit”, edhe “jashtë vendit”. Kjo është e mbartur në të gjitha. Ne thjesht, një sqarim vetëm...

Znj. I. Nano: Domethënë, kini parasysh diçka, ne nuk kemi vetëm këtë akt, ne kemi dhe akte të tjera për të miratuar, padyshim ajo që sapo diskutuam që Kodi herë përmend termin “votues nga jashtë territorit të Shqipërisë”, herë përmend “jashtë vendit”, do të duhet të biem në një dakordësi, për çfarë është më praktike, për t’u përdorur...


Znj. H. Vukaj: Nga ana juaj çfarë është më praktike për t’u përdorur?

Znj. I. Nano: ...sepse do jetë dhe një terminologji që do të përdoret masivisht, jo vetëm në aktet tona po dhe në fushatën e edukimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve qoftë nga ne, qoftë nga partitë politike, çfarë është më praktike, si mendoni ju?

Znj. H. Vukaj: Në kuptim të lehtësisë për ata që do votojnë.

Znj. J. Josifi: “Nga jashtë vendit” e kemi menduar ne që është më qartë, më e përceptueshme dhe më e thjeshtë për publikun.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. H. Vukaj: Prandaj duhet të mendoni që ky term ka më shumë lehtësi për t'u perceptuar dhe për t'u konsideruar.

Znj. J. Josifi: Po

Znj. H. Vukaj: Sepse për hir të teknikës legislative, nuk e di kush përfaqëson Drejtorinë Juridike këtu? I referohemi titullit të një dispozite apo titullit të një ligji për të marrë më pas feedback-un e termave.

Z. M. Çakaj: Pra, në tre nenet e ndryshuar në datë 26 korrik të Kodit Zgjedhor, titujt janë “Kompetencat e KQZ-së lidhur me votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” neni 24, neni 25 “Lista e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” dhe 25/1 “Votimi nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Ndërkohë që në përmbajtje të neneve, për thjeshtësi parashikohet “nga jashtë vendit” ose ne mund të bëjmë titullin “Nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” dhe të ndjekim të njëjtën logjikë që ka ndjekur ligjvënësi dhe në përmbajtje “nga jashtë vendit” për thjeshtësi. Pra anën formale ta ruajmë sipas...

Znj. I. Nano: Atëherë është propozim për t'u ndryshuar, titulli dhe ...

Z. M. Çakaj: ...dhe në projektakt, në thelb të projektaktit, në përmbajtje të lëmë “jashtë vendit” për thjeshtësi.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Atëherë fillojmë me propozimin e parë, zonja Vukaj, ndryshimi i titullit “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës e zgjedhësve”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me pesë vota pro.

Kalojmë siç thamë nen për nen, pikë për pikë.

1. Kreu I Parime të përgjithshme, unë do të filloj të lexoj se pesë janë parimet, pastaj do t’ju jap fjalën. 1. Parimi i transparencës. Procesi i regjistrimit të votimit të zgjedhësve nga jashtë duhet të jetë i hapur dhe i monitoruar në mënyrë që të garantohet informimi i duhur i publikut dhe subjekteve zgjedhore për çdo hap të procedurave. 2. Parimi i thjeshtësisë dhe lehtësisë. Procedurat e regjistrimit dhe të votimit për zgjedhësit jashtë vendit duhet të jenë të thjeshta dhe të lehta për t’u kuptuar e ndjekur nga zgjedhësit duke minimizuar barrën administrative dhe teknike. 3. Parimi i efektshmërisë. Procedurat për regjistrimin dhe votimin nga jashtë vendit duhet të jenë efektive duke synuar që vota e çdo shtetasi të realizohet në kohë dhe pa pengesa të panevojshme. 4. Parimi i aksesit të barabartë. Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote, pavarësisht vendndodhjes së tij, jashtë territorit të Shqipërisë duhet të ketë mundësi të barabarta për të votuar. 5. Parimi i diskrecionit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtën të veprojë me diskrecion brenda limiteve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, me qëllim sigurimin e mbrojtjes së votës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Diskrecioni duhet të ushtrohet në mënyrë që të

***Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

përmirësojmë proceset dhe të adresohen situata të paparashikuara për të garantuar realizimin e votës. Atëherë fillojmë më së pari me subjektet politike. Për këtë kre “Parime të përgjithshme” për secilën nga pesë pikat. Po, z.Nuri.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Faleminderit zonja Nano! Në lidhje me pikën 4, tek fillimi i fjalisë, ku është përcaktuar “Parimi i aksesit të barabartë”, ne si Parti Demokratike do sugjeronim që formulimi të ishte: “Parimi i gjithëpërfshirjes dhe i aksesit të barabartë” meqenëse është dhe një parim i parashikuar në Kodin Zgjedhor. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Parimi i gjithëpërfshirjes dhe aksesit të barabartë, kemi një propozim. Tjetër propozim zonja Xhina, keni ju?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Unë në fakt do të sugjeroja vetëm dy rregullime të teknikës legjislative që i konsideroj që duhet të jenë, p.sh. pika 4 “pavarësisht vendndodhjes së tij jashtë territorit të Shqipërisë” mendoj se duhet të ishte “të Republikës së Shqipërisë” është edhe legjislative dhe “brenda limiteve të përcaktuara” te pika 5, ndoshta “brenda kufijve”...

Znj. I. Nano: Te pika 5?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Te pika 5 “Parime të diskrecionit”, “vepron me diskrecion brenda limiteve”

Znj. I. Nano: “Brenda kufijve” dhe jo “limiteve”? Dakord.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. Xhina, përfaqësuese e PS: Janë thjesht teknikë legjislative. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Dakord. Atëherë nga anëtarët e Komisionit Rregullator kemi propozime? Pastaj të vendosim në radhë votimin. Propozime për këtë pikë? Atëherë fillojmë. Nuk kemi propozime nga anëtarët e Komisionit Rregullator. Kemi një propozim nga z.Nuri i cili në pikën 4, tek kreu I, Parime të përgjithshme propozon shtimin e fjalës “gjithëpërfshirje” para fjalës “aksesit”, pra “Parimi i gjithëpërfshirjes dhe aksesit të barabartë” jam korrekte z. Nuri me propozimin tuaj?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Kalojmë në votimin e këtij propozimi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!


Me pesë vota pro miratohet!

Zonja Xhina kishte propozime që i përkasin teknikës legjislative, në pikën 4 “jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” dhe në pikën 5 zëvendësimin e fjalës “limiteve” me fjalën “kufijve” për ta kthyer në shqip.

Kush është dakord me këto propozime, ju lutem?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Kundër: s'ka!

Miratohen!

Atëherë kalojmë në votimin në tërësi të Kreut I “Parime të përgjithshme” meqenëse pësoi tre ndryshime.

Kush është dakord? Kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me pesë vota pro!

Kreu II “Rregulla të përgjithshme”. 1. Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit në datën e zgjedhjeve dhe dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet për Kuvendin, nga atje ku ndodhet duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim. 2. Regjistrimi i zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit realizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, KQZ.

Kemi propozime nga subjektet për këtë nen? Për këtë kre? Jo! Kolegë keni? Po zonja Xhina!

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Në fakt unë doja do ta shtroja për diskutim, mendoj, ndoshta duhet të ketë ndonjë saktësim të pikës 1 “Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit në datën e zgjedhjeve” mos ndoshta kjo e kufizon? Se kur themi “ndodhet jashtë vendit në datën e zgjedhjeve” mendoj se

***Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

ndoshta duhet nevojë për një lloj saktësim këtu që të mos jetë në interpretim të gabuar, kjo është ideja.

Znj. I. Nano: Kam përshtypjen që kjo është marrë nga Kodi, që do të thotë të drejtën e votës nga jashtë vendit e ka çdo shtetas që ndodhet jashtë territorit në datën e zgjedhjeve, dëshiron të ushtrojë të drejtën. Pra, mendoj që është, thënë me fjalë të tjera pavarësisht që regjistrimi bëhet tani, bëhet në funksion të votimit në datën e zgjedhjeve dhe që ai do të ndodhet ditën e zgjedhjeve jashtë territorit.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Mendoj që lë pak vend për interpretim, gjithsesi.

Znj. I. Nano: E ka vendosur Kodi kështu. Ne na ndodh shpesh që për boshllëqe që ka Kodi Zgjedhor na kërkojnë t'i plotësojmë ne me akte nënligjore po s'kemi gjithmonë autorizim për ta bërë këtë. Atëherë kolegë, ju keni diçka për këtë pjesë? Kalojmë në votimin e kreut II siç ka ardhur nga propozuesi "Rregulla të përgjithshme"?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me pesë vota pro!

Kalojmë te Kreu III "Paraqitja e kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë vendit, afatet dhe dokumentacioni shoqërues", edhe këtë po e lexoj të gjithën dhe pastaj pikë për pikë nëse do të kemi?

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. H. Vukaj: Lexoje titullin.

Znj. I. Nano: Titulli është “Paraqitja e kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë vendit, afatet dhe dokumentacioni shoqërues”. Nuk lodhem ta lexoj sepse duhet të gjithë të kemi vëmendjen maksimale nëse ka shpëtuar diçka, nëse mendojmë që duhet propozuar një proces më funksional. 1. Zgjedhësi që dëshiron të votojë nga jashtë paraqet kërkesë në mënyrë individuale për regjistrim në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim. Afati për paraqitjen e kërkesës fillon 120 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 68 ditë para kësaj date. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton publikisht për hapjen e procesit të hartimit të listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të këtij procesi. Kërkesa kryhet përmes platformës elektronike të regjistrimit, nga këtu e në vijim, në këtë vendim referuar si PER, e cila krijohet, mirëmbahet dhe përditësohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. PER është e aksesueshme pa pagesë për zgjedhësin. Zgjedhësit do t’i jepet mundësia ta shkarkojë këtë platformë si në versionin desktop ashtu dhe në atë mobile, pa qenë i kushtëzuar nga lloji i pajisjes elektronike që do të përdorë. 2. Paraqitja e kërkesës në PER bëhet duke krijuar një llogari në këtë platformë nga vetë zgjedhësi. Krijimi i llogarisë dhe hyrja në të në vijim sipas rastit bëhet nëpërmjet përdorimit të tre faktorë autentifikimi. Një prej faktorëve autentifikues duhet të jetë biometrik, me njohje të fytyrës, “face recognition”, faktori tjetër është një kod unik i përkohshëm 6 shifror që i dërgohet zgjedhësit në numrin e tij të telefonit mobile dhe email si dhe faktori i tretë është numri personal i identifikimit, në ID i zgjedhësit dhe fjalëkalimi. Pika tre e kreut III, 3. Pasi ka krijuar llogarinë e tij në PER për t’u regjistruar, zgjedhësi hyn në këtë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

llogari dhe ndjek këto hapa a. Skanon përmes PER-it një dokument të vlefshëm identifikimi të lëshuar nga Republika e Shqipërisë, pasaportë për jashtë shtetit ose letërnjoftim. PER lexon dhe ngarkon automatikisht në platformë të dhënat që përmban dokumenti i identifikimit. Nëse për arsye të ndryshme këto të dhëna nuk ngarkohen automatikisht atëherë zgjedhësi i ngarkon ato në PER në mënyrë manuale. b. Ngarkon në PER të paktën një dokument që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Lista e dokumenteve të tillë miratohet me akt të veçantë të Rregullatorit. c. Ngarkon në PER të dhënat e mëposhtme: adresën personale të postës elektronike, email, numrin e celularit personal, adresën e banimit e cila duhet të përmbajë të paktën këto të dhëna, shtetin, kodin postar, qytetin, emërtesën e rrugës, numrin e banesës, elemente të tjera të adresës nëse ka. Atëherë përfundova me kreun III. Kush ka ose nëse ka propozime për kreun III nga subjektet? Se u bëtë gati po kemi subjektet së pari.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Faleminderit! Unë desha të ripërsëris dhe njëherë ato sugjerime që në parim i thashë dhe në fillim të nderuar, që ka të bëjë konkretisht me te pika 3, germa “a”, termi “i vlefshëm” identifikimi lidhur me dokumentin, sugjeroj që...

Znj. I. Nano: Cilën pikë të lutem?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Pika 3, germa “a”, “skanon përmes PER-it një dokument të vlefshëm me mjet identifikimi”, sugjeroj që fjala “i vlefshëm” të hiqet. Të jetë një dokument identifikimi i lëshuar nga Republika e Shqipërisë dhe krahas pasaportës për jashtë shtetit ose lejimit, letërnjoftimit, kartës ID, të shtohet dhe leja e drejtimit. Ishte dhe diku në tekst që në mos gaboj pak më sipër...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Dhe njëherë z.Nuri, ndjesë se nuk ju ndoqa. Ku kërkoni që të shtoni të shtohet leja e drejtimit?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Pika 3, “a”, pasaportë, letërnjoftim, leje drejtimi...

Znj. I. Nano: ...e automjetit të lëshuar nga Republika e Shqipërisë apo nga ndonjë autoritet tjetër i huaj.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po dhe për pjesën e vlefshmërisë...

Znj. I. Nano: Po, po këtë lejen e drejtimit, për çfarë leje drejtimi është, leje drejtimi e lëshuar nga Republika e Shqipërisë apo autoritet i huaj? Nëse nuk ka dokumentin të vlefshëm, nuk besoj se ka ardhur të rinovojë patentën nga jashtë...

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Ka mjaft raste, ju siguroj që ka mjaft shqiptarë që mund të jenë në situatë jo detyrimisht të rregullt jashtë...


Znj. I. Nano: Dakord.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: ...që kanë dokument vlefshmërie patente...

Znj. I. Nano: Leje drejtimi të lëshuar..

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Leje drejtimi.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano:.. leje drejtimi të lëshuar nga autoritetet shqiptare në këtë kuptim. Dakord.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po, nga autoritetet shqiptare pse jo sepse në mos gaboj tani dhe lejet e drejtimit të fundit janë dhe me vlerfshmëri 15 vjeçare. Për shembull ai mund ta ketë marrë, shtetasi, përpara disa vitesh dhe mund ta ketë goxha më të vlefshme këtë. Megjithatë kisha dhe një sugjerim tjetër, që ka të bëjë me pikën 2, pak më sipër ku për kodin 6 shifror që do të parashikohet t'i shkohet zgjedhësit në telefon mobile dhe email, mendoj të vihet ose dhe ose email, se jo të gjithë, sidomos personat në moshë të madhe kanë email, është një shqetësim, ose dinë ta përdorin emailin. Ky është një shqetësim që KQZ-ja duhet ta shohi me prioritet sepse përndryshe do të ngeli një kategori mjaft e gjerë e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë shtetit si dhe do ta kenë të vështirë ose mund të jetë një email pastaj që mund ta përdorin disa familjarë, nuk e di, platforma si parashikon këto raste? Sepse mund të ketë shtetas dhe ka shtetas të tillë që janë mbi 80 vjeç p.sh dhe nuk kanë adresë emaili personale, si është parashikuar adresa e emailit. Mendoj që duhet vënë dhe ose, sugjerimi im.

Znj. I. Nano: Dakord.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Ose te kreu mund të ndahet veç si kre, nuk e di.

Znj. I. Nano: Dakord, “dhe”, “ose”. Tjetër keni z.Nuri?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Për momentin jo, nuk kemi.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Znj.Xhina?

Znj. E. Xhina, përfaqësues i PS: Atëherë do më duhet së pari të shpreh një opinion lidhur me propozimin e z.Nuri. Siç u theksua këtu, ky projektvendim është vënë në dispozicion që në 23 shtator apo diçka e tillë dhe propozimi që bën z. Nuri në fakt është një ndryshim thelbësor dhe mjaft i rëndësishëm dhe nuk mendoj se duhej t'i lihej këtij momenti për t'u parashikuar. Gjithsesi zgjedhje e z.Nuri sepse nëse do themi që një shtetas mund të regjistrohet me çdo dokument me sistemin PER duhet të shohim të gjithë frymën e aktit. Unë e kam lexuar të gjithë aktin me kujdes dhe kuptojmë se në këtë akt, momenti i regjistrimit të shtetasit që jeton jashtë trojeve të Shqipërisë lidhet automatikisht, e çon atë në formimin e një liste paraprake të zgjedhësve, pra ç'kuptojmë. Momenti që shtetasi shkon dhe bën këtë regjistrimin në aparaturë, nëpërmjet dokumentit të vlefshëm siç është parashikuar krijohet një listë paraprake e zgjedhësve dhe më vonë nëse do shohim në pikën 5 të seksionit të dytë të këtij projektakti, kjo listë paraprake i bëhet me dije zgjedhësit nëse e konfirmon apo jo që është emri i tij në listë, pra nuk jep një mundësi tjetër që ne të verifikojmë cilat shtetas kanë dokumente identifikimi të vlefshëm apo jo që të miratojmë listën përfundimtare të zgjedhjeve. Pra nëse duhet të propozimi i z. Nuri, përfaqësues i Partisë Demokratike, atëherë duhet rishikuar gjithë fryma e aktit. Pra, do krijojmë një listë zgjedhësish siç është në Shqipëri ku çdo shtetas regjistrohet sepse banon në këtë gjendje civile dhe del lista e zgjedhësve dhe më pas ai mund të votojë me një dokument identifikimi vetëm të vlefshëm apo do jemi sipas frymës së këtij akti, që krijohet një listë paraprake zgjedhjesh por që krijohet në momentin që janë regjistrohet në sistemin PER dhe kjo nuk na jep ne mundësi që të verifikojmë shtetasi ka dokument të vlefshëm identifikimi që i jep atij mundësi dhe të votojë më pas. Pra, kjo sjell konfuzion, ky propozim, sepse ndryshon gjithë frymën e aktit e pastaj sjell

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

nevojën për diskutime të reja e aq më tepër, kjo do shtrohet për diskutim dhe nga ju, ne do na duhet kohë pastaj ta shohim dhe ta mendojmë si mund të integrohet ky propozim në tekst, kështu që parimisht jam kundër këtij propozimi.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Kolegë keni diçka? Unë do të pyesja znj.Josifi.. Por z.Çela.

Z. A. Çela: Unë kisha pyetje për znj.Josifi, për sa i përket pajisjes elektronike të regjistrimit, a ka rrezik që kjo platformë të bjerë nga sistemi kur zgjedhësit të regjistrohen nga jashtë, kur të ketë shumë zgjedhës? Pyetja e dytë është: a ka dhe rrezik për hakerim nga fuqi të huaja, siç ndodhi me shumë site qeveritare tonat nga hakerimi, nga hakerat iranianë që u hakeruan?

Znj. J. Josifi: Nëse mundem, kur te kemi, nëse ju do të vendosni sot që do të kemi një akt nënligjor tjetër për përcaktimin e karakteristikave teknike, ne rezervojmë të drejtën thjesht për efekt që ta mendojmë, t'i përgjigjemi me detaje pyetjes suaj në një moment të dytë, ju lutem. Po sigurisht që ka zgjidhje teknike për të dy rastet që ju përmendët. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit! Z. Çakaj?

Z. M. Çakaj: Po, faleminderit! Atëherë, përpara se të kalojmë në propozime kisha dy pyetje konkrete. Atëherë këtu është parashikuar që, unë kam pak vërejtje për teknikën legjislative sepse në Kreun III titulli është “Paraqitja e kërkesës për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë vendit, afatet dhe dokumentacioni shoqërues”. Pika 1 bën fjalë, citon kërkesën, të parashtrohet kërkesa që duhet të bëjë zgjedhësi

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

nga jashtë vendit, duhet ta paraqesi në mënyrë individuale për regjistrim dhe fjalia tjetër e parashikuar është “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton publikisht për hapjen e procesit të hartimit të listës së zgjedhësve”, pra mos duhet të ishte sepse këtu bëhet fjalë për regjistrim, mos duhet “për hapjen e procesit të regjistrimit”? Ç’i duhet zgjedhësit hartimi i listës, zgjedhësi do kur hapet procesi i regjistrimit, që ta bëjmë më të thjeshtë, meqë titulli i kreut III do të ishte kjo besoj nuk na bie ndesh, pra “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton publikisht për hapjen e procesit të regjistrimit” dhe një parashikim tjetër se në momentin se kur e harton listën por hapjen e procesit të regjistrimit, kur i njofton, koha filloi.

Znj. J. Josifi: Ne kemi përdorur këtë terminologji këtu sepse kemi cituar Kodin, është neni 25, pika 4 fjalia e tretë.

Z. M. Çakaj: Po mirë ta qartësojmë këtë, Kodi ka...

Znj. H. Vukaj: Zonja Josifi të qartësojmë, të lehtësojmë shtetasit

Z. M. Çakaj: ...për hapjen e procesit, le të jetë dhe ky parashikim, procesi i fillimit të hartimit të listës, po hapjen e procesit të regjistrimit në fillim sepse..

Znj. I. Nano: Ato janë njëkohësisht, regjistrim dhe hartim.

Z. M. Çakaj: Dakord.

Znj. I. Nano: Mund të jenë të dyja bashkë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Z. M. Çakaj: Dakord. E dyta, e para kaloi në propozime konkrete, pyetja e dytë: çfarë ndodh, a e keni parashikuar? Se ne s'e kemi PER-in. Sigurisht, shpresoj dhe uroj që kolegët ta shqyrtojnë dhe ta pranojnë kërkesën tonë për hartimin e një akti mundësisht me karakter rregullator nga KQZ-ja, s'ka rëndësi, Rregullatori apo Komisioneri, po nga KQZ-ja një akt me karakter rregullator ku të përcaktohen karakteristikat teknike të kësaj pajisje PER-i, si dhe rregullat për administrimin, përpunimin e të dhënave, për mbikqyrjen. Unë kisha një pyetje konkrete, çfarë ndodh nëse një shtetas shqiptar me banim jashtë vendit kërkon të regjistrohet në pajisje, afatin e vlefshmërisë së dokumentit i skadon, pra e ka të vlefshëm në datën e regjistrimit por i skadon përpara datës së zgjedhjeve, mund të votojë ky shtetas shqiptar? Se nuk e gjej të pasqyruar në akt. Ku është ai momenti, është momenti i regjistrimit apo momenti i votimit?

Znj. I. Nano: Po ai është akt tjetër.

Z. M. Çakaj: Qartë, po çfarë ndodh, regjistrohet për të votuar, po i ka skaduar dokumenti i identifikimit gjatë kësaj periudhe, nga momenti i regjistrimit, është regjistruar me dokument të vlefshëm, momentin e votimit nuk e ka më të vlefshëm. Unë e kam gjysmën e familjes jashtë shtetit, konkretisht në Itali. Vëllait tim për të rinovuar pasaportën iu desh 9 muaj, ka bërë një kërkesë për regjistrim, duhet të merrte takim online në konsullatën shqiptare në Milano, iu vonua tre apo katër muaj dhe pas 9 muajsh është pajisur, ishin dhe vitet e covidit, është pajisur me dokument të vlefshëm identifikimi. Tani, si do t'ia japim këtë të drejtë ne?

Znj. J. Josifi: E kuptova pyetjen, në projektvendim ne kemi thënë një dokument të vlefshëm identifikimi, pra kemi kërkuar vlefshmëri të dokumentit për analogji me

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

kërkesën. Me të njëjtën kërkesë që duhet të plotësojë edhe zgjedhësi ose votuesi brenda vendit kur paraqitet në qendrën e votimit. Për shkak të veçantisë të këtij procesi që zgjedhësi voton nga atje ku ndodhet, pra në asnjë moment nuk paraqitet në një qendër votimi apo në ndonjë vend të përcaktuar për votim, i vetmi moment që ai është përpara një autoriteti që menaxhon një proces zgjedhor, pra në këtë rast KQZ-ja është në thonjëza ky momenti “virtual”.

Z. M. Çakaj: Po pra, PER-i.

Znj. J. Josifi: Ai paraqet kërkesën për regjistrim.

Z. M. Çakaj: e ka të vlefshëm në atë moment, çfarë ndodh nëse i skadon përpara datës?

Znj. J. Josifi: Ne nuk kemi mundësi më, verifikimi, si KQZ, pra nuk ka një ...

Z. M. Çakaj: Po si do konsiderohet vota e tij, e vlefshme apo e pavlefshme?

Znj. I.Nano: Do të votojë apo s’do të votojë?

Z. M. Çakaj: Po, si do të votojë ai? Se e tija, pra komunikimi prandaj do të donim ne edhe një thjeshtësi, qartësi, një demo dhe parashikimin e gjithë situatave të mundshme. Në momentin që ai është regjistruar me sukses, i shkon dhe njoftimi nga KQZ-ja që ai është regjistruar me sukses si zgjedhës i regjistruar nga jashtë, ai e ka pasur të vlefshëm dokumentin, automatikisht do t’i shkojë dhe zarfi me materialet e zgjedhjeve, votën, zarfin sekret e të gjitha, paralelisht ai figuron që e ka përvetësuar

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

të drejtën e votës, e ka fituar, ia ke dhënë të drejtën e votës nga jashtë, ta dërgon, ndërkohë rezulton që i ka skaduar. Si do procedojë KQZ-ja në këtë?

Znj. I. Nano: Kolegë, në fakt thjesht për diskutim sepse...

Z. M. Çakaj: Ne do ta bëjmë prapë, çështja është që ta kemi të qartë që tani vendosim.

Znj. I. Nano: Ne kemi disa momente ose periudha më mirë të themi, kemi periudhën e regjistrimit, që është periudha 120 ditë deri në 63 ditë para, kemi dhe votimin, po them vetëm fjalën votimin dhe pastaj do mundohem të bëj dallimet mes...

Z. M. Çakaj: Rinovimi e nderuar...

Znj. I. Nano: ...ja të lutem shiko, e kuptova po më mirë të themi...

Z. M. Çakaj: Rinovimi i mjetit shqiptar të identifikimit është një proces që kërkon një minimalisht 6 muaj...

Znj. I. Nano:...po ndoshta shkojmë në të njëjtën pikë z.Çakaj. Pse nuk më lejon? Unë nuk ju ndëpreva.

Z. M. Çakaj: Dakord, po ju dëgjoj.

Znj. I. Nano: Tani jam duke shpjeguar dy momente ose dy periudha, periudha e parë është periudha e regjistrimit, që zgjat rreth 60 ditë. Vimë te votimi, në qoftë se për

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

shtetasit shqiptarë me të drejtë vote apo zgjedhësit që do të votojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë kemi vetëm një ditë kur realizohet votimi që është dita e zgjedhjeve, për zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nuk kemi një ditë zgjedhjeje po kemi një periudhë zgjedhjeje, që nis diku dhe përfundon diku, sipas ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, votimi, neni 25, pika 1 “Votimi nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë quhet i çelur nga dita që KQZ-ja nis procedurat për dërgimin e dokumentacionit të votimit”, këtu nis procesi i votimit.

Z. M. Çakaj: Sa është ky afat?

Znj. I. Nano: Deri ditën e zgjedhjeve në orën 19.00.

Z. M. Çakaj: Sa është ky afat, kur nis? Pak a shumë me vlerësimin e gjithë proceseve?

Znj. I. Nano: Ditën e dërgimit...

Z. M. Çakaj: Ditën e dërgimit..

Znj. I. Nano: ...nuk e kam mbaruar, shiko, nuk e kam mbaruar z. Çakaj!

Z. M. Çakaj: ...deri në një muaj.

Znj. I. Nano: Të lutem mos më ndërprit, unë e di se çfarë jam duke thënë.

Z. M. Çakaj: Po jo ta bëjmë debatin të kuptueshëm.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Të mbaroj unë fjalën time dhe pastaj bëjmë debatin. Pra, unë jam duke thënë që po kemi një problematikë këtu, këtë jam duke thënë.

Z. M. Çakaj: Po shumë dakord.

Znj. I. Nano: Po ju ndihmova ju në këtë diskutim sepse parashtrova dhe Kodin Zgjedhor.

Z. M. Çakaj: Shumë faleminderit!

Znj. I. Nano: Të lutem, më shumë e kam për detyrë.

Z. M. Çakaj: Thuaj sa është afati, afati që do i dërgojë KQZ-ja materialet zgjedhore, sa është afati? Jo më shumë se një muaj apo jo?

Znj. I. Nano: Ky afat nuk mund të thuhet sot sepse në momentin që ti duhet të dërgosh fletën e votimit, duhet të jetë fleta e votimit gati, pra ne nuk e llogarisim dot sot...

Z. M. Çakaj: Pra në fakt...

Znj. I. Nano: ...sepse nga një vit në tjetrin ne nuk dimë kur është fleta e votimit gati, doja të thoja që është një periudhë votimi, nuk është datë votimi! Nëse për zgjedhjet e tjera ne e kemi pasur problematikën a ka dokumenta të vlefshëm për të votuar ditën e votimit sepse Kodi Zgjedhor të kërkon që të votosh me një dokument të vlefshëm

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

ditën e votimit dhe në këtë pikë nuk e prekim dot sepse nuk e ka prek ligjvënësi. Tani shtrohet pyetja a ka një dokument të vlefshëm për periudhën e votimit? Pra, veç te regjistrimi, kemi një periudhë votimi, nuk është një datë fikse, që do të thotë në qoftë se kjo është një muaj siç thoni ju, në qoftë se është 27 ditë siç thoni ju, do të duhet që shtetasit shqiptarë që janë jashtë vendit që të mundësojnë votimin do të duhet ta kenë dhe ditën e zgjedhjeve, dhe një ditë para dhe 20 ditë para dhe 35 ditë para, të vlefshme për të votuar, në momentin që votohet. Kjo është periudhë votimi, prandaj këtu kemi një problem! Është tjetër gjë regjistrimi, nëse duhet dokument i vlefshëm, i pavlefshëm, duhet shtuar një dokument tjetër siç thotë z.Nuri dhe pastaj është tjetër gjë votimi. Mendoj që kjo shkon pak përtej nesh, që do të thotë, në mënyrë të ndërgjegjshme ne nuk mundet të votojmë për, këtu së bashku, për votimin me akte që kanë skaduar! Unë personalisht nuk e marr përsipër ta bëj këtë. Në momentin kur flasim për votimin, ndoshta në një akt tjetër, po aktet janë të lidhura. Ky i sotmi, nga ajo çka do vendosim në sot mund të na diktojë disa gjëra për nesër pasnesër, pra në qoftë se ne vendosim një parim, një rregull sot, ky rregull do të duhet të përdoret, pra nuk mund t'i rikthehemi prapë dhe të themi, a e kishim gabim atë moment që bëmë këtë votim. Prandaj edhe unë bashkohem me shqetësimin tuaj, të znj.Xhina, të z.Nuri, lidhur me çështjen e vlefshmërisë dhe afateve për vlefshmërinë, në regjistrim dhe në votim që është një periudhë relativisht e gjatë, fillon 120 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe deri ditën e zgjedhjeve në orën 19.00, janë katër muaj! E zgjidhim dot si Rregullator këtë gjë sot? Ç'do të ndodhë me vlefshmërinë ose me mënyrën se si do të regjistrohen dhe si do të votojnë shtetasit shqiptarë jashtë vendit kur ne nuk dimë çfarë ndodh në këtë periudhë katër mujore, nuk është një ditë më, kolegë, nuk është një ditë! Kemi qenë këtu prezent në ditët, në zgjedhjet e shkuara, kemi patur raste të ndryshimeve të akteve të tjera ligjore lidhur me vlefshmërinë ditën e zgjedhjeve por këtu bëhet fjalë për një periudhë 4

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

mujore, kështu që kjo gjë duhet menduar mirë po shumë mirë, qoftë dhe propozimi që sapo na bëri z. Nuri lidhur me një dokument tjetër, me një shtesë në dokument apo me mundësinë e regjistrimit me një dokument të skaduar ose të vlefshëm.

Z. M. Çakaj: Një sekond, atëherë, më fal, në vijim të pyetjeve, atëherë unë kam dy propozime konkrete në lidhje me këtë. Kreu III, “Paraqitja e kërkesës..”, së pari propozimi të sqarohet pra hapja e procesit të sqarohet, dhjetë ditë para Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton publikisht për hapjen e procesit të regjistrimit, momentin ekzakt dhe më pas mund ta mendojmë dhe këtë parashikimin. Po, të ndahet pikë më vete, pra të njoftojë publikisht hapjen e procesit të regjistrimit të shtetasve shqiptarë, të zgjedhësve shqiptarë me banim jashtë vendit së pari. Së dyti lidhur me PER-in, pas fjalisë “zgjedhësit do t’i jepet mundësia ta shkarkojë” ose përpara në momentin që, pra në pikën 1 kërkesa kryhet përmes platformës së regjistrimit nga këtu e në vijim, në këtë vendim referuar si PER, e cila krijohet, mirëmbahet dhe përditësohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”. Këtu propozoj të shtojmë fjalinë: “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me akt të Rregullatorit duhet të përcaktojë karakteristikat teknike dhe rregullat për krijimin, mirëmbajtjen, administrimin, përditësimin e të dhënave të PER-it dhe mbikqyrjen”.

Znj. I. Nano: Z.Çakaj mundem, nëse ju keni mbaruar propozimin?

Z. M. Çakaj: Jo kam dhe diçka. Patjetër jemi të hapur të gjithë për diskutim, përveç kësaj jam i hapur për propozimet e mia. Përveç kësaj, në pikën 3, pra që është procedura e regjistrimit të zgjedhësit nga jashtë. Atëherë në Kodin Zgjedhor, parashikohet që Komisioni Rregullator do të miratojë një akt për hartimin e listës së dokumentave që ka nevojë zgjedhësi nga jashtë për të provuar se ai jeton dhe banon

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

rregullisht ose jo rregullisht jashtë shtetit. Pra, do të provojë se ai në datën e zgjedhjeve, përpara dhe në datën e zgjedhjeve është, ndodhet jashtë shtetit. Pra, ligjvënësi ka parashikuar një kategori, listë dokumentash, të cilat do të duhet, ligjvënësi, më fal zgjedhësi t'i ngarkojë në PER ose t'ia bëjë me dije KQZ-së. Unë i propozoj kolegëve për ta shtyrë pak në kohë, t'i japim mundësi të gjitha palëve që këtë listën e dokumentave të cilat do të duhet ta ketë zgjedhësi në momentin që paraqet kërkesën për identifikimin e tij në PER. Pra, bashkë me aktin, bashkë me listën e dokumentave që ai provon jetesën e tij jashtë, të ketë dhe listën e dokumentave, dokument identifikimi shqiptar, kartë identiteti, patentë apo pasaportë të vlefshme apo të skaduar apo një dokument identifikimi të një shteti tjetër, do ta vendosim të gjithë bashkë. Atëherë duke qenë se kemi të bëjmë me momentin procedural, kur shtetasi do të regjistrohet dhe krahas listës së dokumentacionit që provon adresën do të ketë dhe dokumentacionin e tij personal me një akt të posaçëm t'i miratojmë të dy këto. Do të ishte më e udhës, edhe më e thjeshtë dhe për shtetasin. Pra të jetë një lloj dokument, akti të jetë i qartë ai shtetasi, zgjedhësi shqiptar që është jashtë të jetë i qartë, të ketë edhe dokumentin edhe kontratën e qirasë apo faturën e gazit, apo vërtetimin e rezidencës. Çfarëdo lloj dokumenti i cili provon ligjërisht ose joligjërisht ekzistencën e tij në datën e votimit jashtë vendit. Kështu që unë do t'iu sugjeroja kolegëve që ta shtyjmë, ta diskutojmë, të marrim dhe mendimet e gjithë palëve të interesuara dhe në një moment të dytë. Se nuk jemi që të gjithë të qartë, nuk jemi të qartë dhe për këtë do doja, është shumë e rëndësishme, do doja ta zgjidhnim dhe ta ceknim nga pikëpamja teknike por dhe nga pikëpamja përmbajtësore atë minicasusin ose situatën faktike ku mund të ndodhemi. Pra e ka dokumentin e vlefshëm apo jo në momentin e regjistrimit, s'e ka, do të duhet të jemi të qartë që të gjitha, që të mos krijojmë konfuzion. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Në funksion të diskutimeve, të sapo bëra nga kolegët, por dhe të propozimeve që dëgjuam, më lejoni që në kuadër të teknikës legislative të parashtroj ose të hedh për diskutim apo propozim. Konsiderojeni vetëm në të mirë të aktit se pas rregullave të përgjithshme në këtë akt, nuk duhet të fillonte një kre i cili thjesht, në mënyrë eksplicite identifikohet me një numër III, romak, por nuk ka asnjë titull tjetër që mund t'i japë vlerën e kreut dhe pas “Rregullave të përgjithshme”, në fakt për teknikë legislative duhet të kishte “Rregulla të posaçme”, të cilat duhet të identifikonin karakteristikat ose veçoritë, tiparet, specimentet apo quajeni si të doni të shtetasit shqiptar që ka dhe gëzon të gjithë të drejtën e ushtrimit të votës nga jashtë. Pra, këtu tek rregullat e posaçme, po shoh që po bien dakord edhe partitë politike në këtë kuadër. Rregullat e posaçme duhet të identifikonin shtetasin shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë territorit të Shqipërisë. Unë nuk e gjej këtu dhe nuk kuptoj arsyen që pse rrëmbimthi dhe mënyrë kaq konfuze është dashur menjëherë të shkohet tek PER, tek regjistrimi, te dokumentimi, ndërkohë që ne kemi komplet një akt të veçuar ku duhet, siç parashtruat edhe ju nga matrica e akteve, që duhet të kualifikojmë, të miratojmë të gjithë listën e dokumentave që do ta bënin të vlefshëm, të drejtën kushtetuese të votës së emigrantit të ndodhur jashtë shtetit. Në këtë kuadër, unë mendoj që ky kre ka nevojë jo vetëm të copëtohet, por të rishikohet me shumë vëmendje dhe të marrë kohën duhur. Duke u grupuar në një ose në një akt të veçantë të gjithë dokumentat që identifikojnë një shtetas shqiptar dhe që çelin siparin e procesit të regjistrimit ose të vendoset këtu, të inkorporohet këtu si rregulla të posaçme dhe më pas të kalojmë tek pajisja, tek platforma, tek procedura që do të implementohet përmes platformës. Unë këtë nuk e gjej dhe kërkoj absolutisht që ne të diskutojmë dhe të marrim kohën e duhur për ta përmirësuar pikërisht këtë kre, i

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

cili nuk është i qartë. Kur nuk është i qartë për ne dhe ka boshllëqe dhe pasigurira, jo më për ata që do ta aplikojnë, të cilët ende nuk dinë. Befas, kur kolegu solli shembullin, mua më erdhën në kokë një mijë shembuj të tjerë, një shtetas që banon në Amerikë, në moshë të thyer, në Kaliforni, në Siatëll duhet të shkojë, duhet të lërë punën, të gjithë aktivitetet dhe njëi afërm duhet të shkojë dhe të merret me procesin e vlefshmërisë së apo rinovimit të dokumentave të identifikimit që ndoshta dhe s'i është dashur po për krenari ka mbajtur një pasaportë ndoshta dhe me ngjyrë të kuqe dhe jo vishnje, që jam shqiptar, duhet të shkojë në Washington dhe vallë a i jepet kjo mundësi ta marrë fizikisht apo mos ta marrë fizikisht. Bëni llogaritë sikur një familje në Amerikë emigrantësh prej 5 vetash minimalisht apo katër vetash të jetë në ngërçin e vlefshmërisë së dokumentave, do t'ia mohojmë të drejtën e votës? Nuk do t'ia krijojmë mundësinë përmes një dokumenti identifikimi i cili nuk zhbën as qenien e tyre gjallë dhe as identifikimin e tyre sepse ID është efikase dhe efektive dhe e regjistruar në regjistrat fizikë dhe elektronikë të shtetit shqiptar dhe lehtësisht mund të identifikohet. Ne kemi qenë këtu dhe jemi bërë partizanë me vullnet të plotë si palët politike dhe ashtu aktorët e tjerë për t'i dhënë ritëm dhe për t'i dhënë të drejtën momenteve kur shtetasit shqiptarë nuk kishin mundësinë për hir të një dokumenti të pavlefshëm dhe kjo ka ndodhur me dhjetra herë edhe nga ky Komision. Komisioneri vetë në zgjedhjet para Himarës dhe nuk e di se çfarë ndodhi me zgjedhjet e Himarës që nuk e realizoi, ka realizuar ndërveprime dhe bashkërendime menjëherë me ministrinë përkatëse, për t'u rinovuar dhe për t'u quajtur të vlefshme këto dokumenta. Kështu që merreni në konsideratë faktin që dokumenti i identifikimit, nuk zhbën qenien e një shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk e zhbën ai, është i vlefshëm. Merrni rastin e Spanjës, e elaboruar dhe nga analistë apo gazetarë të ndryshëm, Spanja apo Franca, e cila ndjek shembullin e vlefshmërisë së një dokumenti, mjafton edhe 5 vite para të ketë qenë i vlefshëm, pra

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

i vlefshëm në kuptimin dhe do bie në nivelin e një pyetje shumë banale. Më mirëkuptoni, e kam për të gjitha ata, kategoritë e emigrantëve që ndodhen, të çfarëdo lloj përkatësie apo moshe që ndodhen jashtë vendit, të kuptojnë çfarë presupozoni ju të nderuar me dokument i vlefshëm? Sepse unë pasaportën, thotë, apo kartën e identitetit mund ta kem të vlefshme nga ana ligjore por fizikisht e kam të dëmtuar, më është dëmtuar si fotografia, apo më është grisur apo më është thyer një cep apo më është grisur një pjesë e pasaportës, si do procedohet në këtë rast? A do të quhet kjo e vlefshme? Pra në mungesën e qartësisë pra nuk janë në këtë akt këto rend dokumentasht, duhet të jenë ose tek akti që inkorporon gjithë setin e dokumentacionit ose pastaj të shikojmë se çfarë lëmshi është këtu dhe të gjejmë fillin dhe pastaj të bëjmë sikur bëmë një akt dhe të bëjmë sikur i dhamë mundësinë.

Znj. I. Nano: Atëherë znj. Vukaj, ju sapo thatë mund ta ketë të vlefshme por e ka të dëmtuar. Ç'kuptoni ju vetë me akt të vlefshëm nga këndvështrimi ligjor? Të dëmtuar e kuptojmë, atë cepin e ka thyer.

Znj. H. Vukaj: Nëse ju jeni duke më vënë në test mua se ç'kuptoj me dokument të vlefshëm...

Znj. I. Nano: Jo, jo!

Znj. H. Vukaj:...kjo nuk duhet të ishte pjesë e kësaj foltoreje, por unë doja nga administrata të kuptoja pse është në linjën propozuese. Nëse do të isha unë në linjën time propozuese, do t'i jepja pa asnjë lloj pengese të gjithë shtetasve shqiptarë të drejtën për të votuar, pa ekuivok sepse është e drejtë kushtetuese. Ne e dimë jashtazakonisht mirë se me çfarë vështirësish mund të jenë larguar shqiptarët, të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

ndodhur në azil politik apo në azil ekonomik apo ku di unë, të fshehur edhe nga policia për t'i shpëtuar, ndoshta kushteve jo të mira ekonomike këtu apo kushteve të tjera të papërshtatshme, jetesës në Shqipëri. Kështu që ju lutem këtë rezervojeni t'ia bënit administratës, jo mua.

Znj. I. Nano: Atëherë ne sot jemi duke diskutuar një akt për rregullat e regjistrimit nuk jemi ende te votimi. Padyshim që lidhet regjistrimi me votimin se janë procese në funksion të njëri-tjetrit. Në fillim të prezantimit znj. Josifi na tha që është hequr lista e dokumentave të cilët duhet të vërtetojnë qëndrimin jashtë territorit për t'u miratuar me një akt më vete sepse janë dokumenta që lëshohen nga shtetet aty ku qëndrojnë shqiptarët jashtë vendit, pra për të vërtetuar vendbanimin ose qëndrimin më mirë të themi në një shtet tjetër, jo Shqipëri. Në këtë moment jemi duke diskutuar vetëm për të krijuar një llogari zgjedhësi në këtë platformë. Çfarë dokumenti i duhet? Më pas e krijoi llogarinë e vet, mund të hyjë ta download-jë një dokument tjetër, një tjetër më vonë. Tani se çfarë thotë Kodi Zgjedhor për dokumentin që duhet ditën e votimit besoj që nuk kemi dyshim të gjithë që duhet një dokument i vlefshëm dhe thashë kjo shkon përtej nesh si Komision Rregullator. Çfarë ndodh me vlefshmërinë e dokumentave të identifikimit të shtetasve shqiptarë për të votuar në periudhën e votimit, po e theksoj dhe njëherë, nuk është një ditë. Pra, kjo e vështirëson edhe më tej gjënë, pra sa i përket regjistrimit ne kemi këtë propozim që thotë z.Nuri. E para për të hequr fjalën “të vlefshëm” nga dokument identifikimi, e dyta për të shtuar “leje drejtimi”, në këtë moment. Kemi pastaj propozimet e z.Çakaj. Personalisht bie dakord.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. H. Vukaj: Keni për propozim copëtimin që sapo përmenda. Kërkoj që akti, pra kreu III të fillojë me “Rregulla të posaçme” ose të identifikohet shtetasi shqiptar këtu ose e gjitha të inkorporohet, gjithë seti i dokumentave në një akt të veçuar.

Znj. I. Nano: Seti i dokumentave do të jetë në një akt më vete, po dokumentat për jashtë.

Znj. H. Vukaj: I dokumentave, pasi e kanë konsideruar shtetas efektiv për të votuar, pra le të përmendim këtu në parim një dokument identifikimi dhe më pas të kalojmë dhe i shpjegojmë atje se kush janë dokumenta të vlefshëm, kush janë të pavlefshëm e kështu me radhë.

Znj. I. Nano: Nuk kushtëzojnë njëri-tjetrin këto znj. Vukaj, pra seti i dokumentave që kërkohen për t’u identifikuar në platformë, padyshim që është një set ose dokument shumë i ndryshëm nga seti i dokumentave që duhen për të verifikuar, për të vërtetuar qëndrimin jashtë shtetit. Në kuptimin që janë dokumenta të prodhuara nga një autoritet i huaj, jo nga një autoritet shqiptar. Ndërkohë unë, më duhet të bëj dhe një vështrim historik se çfarë ka ndodhur. Në 2020 ne patëm ndryshimet e Kodit Zgjedhor, ku për herë të parë ligjvënësi vendosi por sipas Gjykatës Kushtetuese, mesa duket nuk vendosi në mënyrë të plotë, mënyrën sesi do të votonin, regjistroheshin dhe votonin shtetasit shqiptarë, të mos harrojmë që në legjislacionin e vitit 2020 ne kishim dy procese të ndara njëri me tjetrin, njëri i rregulluar me një ligj, tjetri i rregulluar me Kodin Zgjedhor. Më së pari kërkohej regjistrimi i shtetasve në e-albania për të deklaruar adresën, jo domosdoshmërisht në funksion të votimit, por në funksion të marrjes së shërbimeve të tjera dhe më pas ata që ishin të regjistruar në e-albania do të shprehnin vullnetin të votonin, pra si një hap i dytë. Kurse sot

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

regjistrimi dhe lista e zgjedhësve janë procese në funksion të njëri-tjetrit, nuk kanë lidhje me asgjë tjetër, pra ti regjistrohesh për të hyrë në listën e zgjedhësve, këto janë dy procese, edhe Kodi Zgjedhor kështu e nis, përgatitja e listës së zgjedhësve, pra janë në funksion të njëri-tjetrit. Le të shohim ato që janë shumë shqetësuese sa lidhen me identifikimin dhe me vlefshmërinë, ndërsa këto janë procese që shkojnë, nuk është se shkojnë njëri pas tjetrit, janë një në vetvete, pra në momentin që regjistrohet një person, aty ka filluar lista e zgjedhësve, është shënuar në një listë. Po z. Çakaj.

Z. M. Çakaj: Atëherë, unë ndaj opinionin të ndryshëm nga ju e nderuar, ku qartazi kërkon të ndani ose të identifikoni listën e detajuar të dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve, si listë e dokumentacionit, adresa. Nuk është kështu! Neni 25, pika 5 e Kodit Zgjedhor, fjalia e fundit e përcakton në mënyrë të qartë, “Lista e detajuar e dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve, që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përcaktohet me vendim të Rregullatorit”, që do të thotë nga administrata, nga Komisioneri do të përgatitet një listë e detajuar, po kjo nuk e ndan vetëm për adresat, për verifikimin e adresave, kjo mund të jetë, do të përfshihet edhe dokumentacioni për regjistrimin sepse e ka thënë qartë ligjvënësi, lista e detajuar e dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve, me vendim të Rregullatorit. Lista e detajuar për regjistrimin e zgjedhësve janë dy kategori: lista e dokumentave të identifikimit dhe lista e dokumentave që provojnë qenien e tij jashtë shtetit, në mënyrë të ligjshme ose të paligjshme. Unë mendoj që akti i cili do të normojë dokumentacionin se çfarë duhet të paraqesi zgjedhësi nga jashtë vendit, qoftë për regjistrimin dhe është proces i pandarë sepse ti kur e regjistron atë nuk do t’i thuash, shiko regjistrohu tani me një dokument të vlefshëm dhe hapi i dytë do të jetë, më korigjo të lutem administrata nëse jami gabuar. Si e mendoj unë procesin e regjistrimit, zgjedhësi nga jashtë vendit

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

duhet të ketë disa dokumenta përpara PER, do të duhet të ketë një dokument identifikimi dhe do duhet të ketë një dokument ose disa dokumenta të tjerë të cilët provojnë ekzistencën e tij jashtë. Pra është një proces dhe lista e detajuar e dokumentacionit, në momentin e regjistrimit përpara PER-it do të jetë. Unë mendoj që këtë ta nxjerrim jashtë në një akt tjetër dhe ta miratojmë. T'i japim dhe kohë palëve.

Znj. I. Nano: Po pra, ky është propozimi juaj që edhe këtë që themi...

Z. M. Çakaj: Mos ta kalojmë në ngërç.

Znj. I. Nano:...çfarë dokumenti i duhet për identifikim, ta ketë.

Z. M. Çakaj: Po pra, të gjitha listën e dokumentave

Znj. I. Nano: Kjo nuk copëzon më aktin, kjo thjesht nxjerr, po pra do vejë te dokumentacioni tjetër. Jo, nuk propozon më aktin kjo të jep...

Z. M. Çakaj: ..kjo ta nxjerr jashtë...

Znj. I. Nano: Po pra, ai dokumentacioni tjetër...

Z. M. Çakaj: Po kaq

Znj. I. Nano: Si do ta propozojë më ai, thjesht do heqim, këtë që thoni ju.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Z. M. Çakaj: Po ky pra ishte qëllimi, pika 3.

Znj. I. Nano: Tani u kuptuam bashkë se u qartësua propozimi. Propozimi është të hiqet pika a.

Z. M. Çakaj: Jo pika 3

Znj. I. Nano: Shkronja “a” e pikës 3 ...

Znj. H. Vukaj: Ju lutem zonja Nano! A mund të marrim kohë për hir të integritetit të aktit dhe për hir të vlerësimit më qartë të të gjithë propozimeve?

Znj. I. Nano: Dakord. Kolegë?

Z. M. Çakaj: Dhe diçka të keni në konsideratë për propozimin dhe miratimin e një akti me karakter rregullator për karakteristika teknike.

Znj. I. Nano: Tani po themë Rregullator ia kemi ngarkuar vetes.

Z. M. Çakaj: Jo, mund ta bëjë edhe...

Znj. I. Nano: Nuk mund të themi Rregullator, pra nëse e vlerësojmë të ketë një akt. Këtë ta diskutojmë me propozuesin.

Z. M. Çakaj: Po jo, shiko gjithë paketën e propozon Komisioneri apo këtë ka parashikuar dhe ligjvënësi ia propozon Komisionit Rregullatorit.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Po pra aktet nënligjore me karakter rregullator.

Z.M. Çakaj: Vullnetin dhe me dakordësinë tonë e keni me pash pro për të bërë gjithçka...

Znj. I. Nano: Kush jeni ju që thatë “tonë”...

Znj. H. Vukaj: Ne kemi autorizim..

Znj. I. Nano: Ne kemi njëri-tjetrin dhe votojmë të gjithë së bashku...

Z. M. Çakaj: Jo meqë, po shikoni herë pas here, shikoni majtas pastaj djathtas, pra të jemi të qartë në këtë pikë. Tani ideja është këtu, do t’i japim rregullat, do t’i bëjmë rregulla të thjeshta për shqiptarët? Rregulla të qarta për të gjithë shqiptarët që jetojnë banojnë jashtë? Sa të gjejmë dakordësinë? Nëse do t’i bëjmë të thjeshta, të qarta, ulemi ta diskutojmë.

Znj. I. Nano: Deri tani dakordësia paska qenë te dokumentacioni jo te rregulli.

Z. M. Çakaj: Si te dokumentacioni?

Znj. I. Nano: Po pra çfarë dokumentacioni do të sjelli dhe çfarë...

Z. M. Çakaj: Unë shtrova pyetje dhe nuk mora përgjigje.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Vetëm dokumentacioni.

Z. M. Çakaj: Shtrova pyetje dhe nuk mora përgjigje. Kam dhe një problem tjetër, një diskutim tjetër që me të drejtë e kam ngritur shqetësim KRIIK-u, po kur të vijë momenti, kush do ta kryejë procesin e identifikimit, normalisht apo do të kryhet elektronikisht nga pajisja elektronike, procesin e identifikimit që unë jam unë?

Znj. H. Vukaj: Kush e kryen?

Z. M. Çakaj: Me elementët e njohjes së fytyrës, kush do ta kryejë atë? Sepse mund të ndodhi, vjen një shtetas shqiptar i cili ka numër, ka kartën time të identitetit, më regjistron mua nga jashtë vendit, a do të ketë një proces verifikimi, verifikimin e identitetit të zgjedhësit, kush do ta kryejë? Unë e kam të paqartë këtë gjë? Nuk e gjej të qartë këtë gjë.

Znj. I. Nano: Atëherë z.Çakaj vetëm një pyetje.

Z. M. Çakaj: Është me kartë...

Znj. I. Nano: Atëherë unë kam një propozim, të paktën nga dy kolegë u kërkua që ta shtyjmë seancën në një moment tjetër. Ju kolegë si mendoni? Dakord, unë gjithashtu jam dakord. Atëherë nëse kemi ndonjë pyetje apo paqartësi t'ia drejtojmë tani, pra përveç kësaj, t'ia drejtojmë tani administratës, në mënyrë që për seancën e radhës, mbledhjen e radhës, të jemi të...

Z. M. Çakaj: Mund të jetë dhe sot.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Po pra kur themi e radhës mund të jetë pas dy orësh, mund të jetë pas pesë orësh.

Znj. H. Vukaj: Këtu gati jemi.

Znj. I. Nano: S'ka problem fare, kur them e radhës, nuk thashë një ditë tjetër.

Znj. H. Vukaj: Me këtë rast të lutem edhe sugjerimet e KRIIK, t'i rishikoni se mund të dalin plotësime të tjera sepse i gjej me vend.

Znj. I. Nano: Atëherë proceduralisht kemi diçka znj. Vukaj, akti zyrtarisht na ka ardhur është ky, që do të thotë ne në seancë, në mbledhje kemi të drejtë të bëjmë shtesa...

Z. M. Çakaj: Vërejtje, sugjerime..

Znj. I. Nano: ...ndryshime, propozime për ndryshime, për amendime, për shtesa, pa dyshim që administrata do të duhet t'i shohi dhe njëherë ato që në momentin që ne do të kemi pyetje gjatë shqyrtimit të një neni konkret të na japi përgjigjet e duhura. Atëherë deri tani kemi arritur të miratojmë dy krerët e projektaktit, kreun I dhe kreun II, vijojmë me kreun III në një moment që do të njoftohet mbasi të...

Z. M. Çakaj: T'ia bëjmë dhe pyetjet, që ndoshta mund të kemi?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Po, nëse keni pyetje të tjera për administratën, që t'i mbajë shënim për seancën e radhës.

Z. M. Çakaj: Atëherë unë kisha, së pari do të doja të isha i qartë nëse do të ishte mundësia edhe me një paraqitje grafike, nuk e di nëse do ta arrini, po nëse jo të paktën të isha i qartë nga shpjegimet e administratës drejtorisë përkatëse lidhur me procesin e identifikimit, procesin e verifikimit të identifikimit, të identitetit të zgjedhësit që kërkon të regjistrohet nga jashtë vendit. Kush e kryen? Verifikimin e identitetit, kryhet në mënyrë elektronike apo kryhet në mënyrë manuale, së pari. Së dyti edhe ligji, ndryshimet ligjore parashikojnë që në mënyrë dinamike ne do të bashkëpunojmë me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, madje është parashikuar dhe me një udhëzim, ka një akt të përbashkët, e kemi hartuar aktin se më duket se ishte me afate, ka një marrëveshje, është i Komisionerit, thjesht për shpejtësi të procesit, thjesht me karakter informues është pyetja ime, ta dimë që të eci procesi.

Znj. J. Josifi: Sa i takon, nuk po i përgjigjem pyetjes së parë meqë u vendos shtyrja në mos gaboj e seancës. Sa i takon aktit të përbashkët të parashikuar për mënyrën e bashkëpunimit midis Komisionerit dhe ministrit përgjegjës për Gjendjen Civile dhe ai kishte një afat që ishte 60 ditë nga hyrja në fuqi e ligjit. Ne kemi përgatitur nga ana jonë një draft, të cilin ia kemi përcjellë për mendim, Komisioneri ia ka përcjellë për mendim Ministrit të Brendshëm në këtë rast, me shkrim, në datën 11 tetor, të premtën e kaluar. Nuk kemi ende një përgjigje, pra ne bëmë një draft, të njëanshëm po themi kështu, pra propozimin tonë, do të duhet të ketë dakordësi, mendime ose dhe vullnetin.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 18.10.2024*

Znj. I. Nano: Ky është procesi, znj. Josifi, e çuam, e solli, e ktheu, e vlerësoi, jemi në proces, nuk është miratuar, është e qartë tani, mos të merremi me akte që nuk na takojnë ne. Ne le të diskutojmë aktet që na takojnë ne, për aktin tonë, ne nuk marrim dot përsipër të rregullojmë gjithë aspektet e një procesi zgjedhor, do rregullojmë ato që na takojnë ne.

Z. M. Çakaj: Nuk ka përfunduar, e mora përgjigjen, ende nuk ka akt, faleminderit!

Znj. I. Nano: Po pra. Ka ndonjë përgjigje tjetër për t'i kthyer z. Çakaj apo të tërhiqemi dhe të vlerësojmë me njëri-tjetrin një kohë të përshtatshme për t'u rimbledhur? Nuk kemi të tjera. Mirë do të rimblidhemi, për orën, nëse do të jetë brenda ditës së sotme, do të njoftoheni, për datën nëse do të jetë jo sot, gjithashtu do të njoftoheni, vendin e dini ku zhvillohet mbledhja. Faleminderit për praninë të gjithëve!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

